



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Turizëm”

ofruar nga

Universiteti “EQREM ÇABEJ”, Gjirokastrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Çlirim Duro

Prof.As. Sonila Papathimiu

Nëntor/2024

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në "Turizëm"

1	IAL aplikues:	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Turizëm"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH nr. 5358 prot., datë 22.08.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 334, datë 13.07.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 Ects
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2022: 17 PAE/ 3 PAK 2022-2021: 20 PAE/ 4 PAK 2021-2020: 22 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve:	Stud. Viti 2020-2021: 13 2021-2022: 5 2022-2023: 31
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Turizëm” ofrohet nga Universiteti “Eqrem Cabej”, Gjirokastër. Njësia kryesore ku bën pjesë ky program studimi është Fakulteti i “Ekonomisë” dhe Njësia Bazë që e ofron këtë program studimi është Departamenti i “Politikave Ekonomike dhe Turizmit”. Programi është licensuar me Shkresë nr. 5358, datë 22.08.2005.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i “Ekonomisë” përbëhet nga 3 Departamente:

1. Departamenti Administrim Publik,
2. Departamenti Kontabilitet -Financë,
3. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit

Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të parë Bachelor në “Turizëm” dhe synon të përgatisë profesionistë të fushës së turizmit me standarde të larta bashkëkohore. Ky program studimi është hartuar për të siguruar formim të profilizuar, në gjendje që i diplomuari të veprojë me aftësi dhe pavarësi profesionale në fushën e turizmit si dhe të sigurojë profesionistë të rinj që t’i shërbejnë vendit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në Universitetin “Eqrem Cabej” Gjirokastrë u përgatit nga dy profesorë me përvojë dhe ekspertë të fushës: Prof.As. Çlirim Duro dhe Prof.As. Sonila Papatimiu. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga koordinatori teknike e ASCAL, Msc. Rajna Lila.

Ekspertët e vlerësimit bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UGJ dhe në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, kanë kryer vlerësimin e jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Turizëm”. Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastrë.

Gjatë këtyre ditëve u zhvilluan takime me përfaqësues të këtij institucioni, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Departamentin e Politikave Ekonomike dhe Turizmit, grupin e punës dhe stafin e programit për të kuptuar dhe pyetur më tej në lidhje me vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit të studimit.

Takime u zhvilluan dhe me studentët e programit të studimit, si dhe zyrat administrative të Sekretarisë mësimore, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit si dhe në Bibliotekën e Universitetit.

Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar për gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport dhe kanë rënë dakord për vlerësimin e standardeve sipas rubrikave përkatëse. Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për programin e studimit Bachelor në “Turizëm”, ofruar nga Universitet “Eqrem Cabej” Gjirokastrë.

Universitet “Eqrem Cabej” Gjirokastrë, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 85/52 Prot, datë 29.10.2024. Universitet “Eqrem Cabej” Gjirokastrë, njofton në ASCAL më datë 31.10.2024, me anë të shkresës me Nr.1642 Prot, datë 31.10.2024 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, IAL shprehu dakortësin mbi draftin e dërguar.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Turizëm”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastrë (UGJ), evidenton se ofron programe studimi në përputhje e në shërbim të interesave kombëtare të vendit, duke zbatuar Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, kreu 1, neni 1. UGJ ka në qendër të punës së tij respektimin e ruajtjen e vlerave akademike, kulturore e kombëtare, duke vënë në shërbim të këtij synimi kapacitetet njerëzore e intelektuale. UGJ synon arritjen e zhvillimin e një sistemi arsimor gjithë përfshirës, për të ofruar mundësi të barabarta për të gjithë pa dallime të asnjë lloji.</p> <p>Në aktet rregullatore të institucionit theksohet se programet e studimit kanë qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqenies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë” 80/2015, Strategjinë Kombëtare të Arsimin, Statutin e UGJ, dhe gjithë bazën ligjore në fuqi. Ky program studimi u hap si nevojë e kohës dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut për profesionistë në fushën e turizmit.</p> <p><i>Evidence 1.1 Statuti i UGJ</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin e UGJ, me qëllimet e këtij universiteti, duke synuar arritjen e standardeve akademike, bashkëkohore e ndërkombëtare, në përkrahje të aspiratave akademike dhe arritjet e gjithkujt që kërkon të përfitojë nga arsimit i lartë. Qëllimi i këtij programi studimi me studentin në qendër, dokumentohet në Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit. UGJ dhe Fakulteti Ekonomik synojnë të ofrojnë një formim të plotë në fushën e turizmit me qëllim dhënien e aftësive të nevojshme për mundësinë e punësimit në tregun lokal, rajonal dhe më gjerë.</p> <p><i>Evidence 1.1 Statuti i UGJ</i> <i>Evidence 1.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik Evidenca 1.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Turizëm</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dhe evidencat e dorëzuara nga UGJ, ky program studimi është hartuar në përputhje me strategjinë e Universitetit. Në këtë dokument institucioni thekson rëndësinë e përmirësimit të rritjes së cilësisë së programit të studimit në zbatim të strategjisë së UGJ dhe referuar Planit të Zhvillimit Strategjik të institucionit.</p> <p>Sipas vizitës në institucion dhe shqyrtimin e dokumentave të institucionit, ky program studimi plotëson nevojat e kërkesat e tregut për profesionistë të tregut në fushën e turizmit. Ky program studimi ka në qendër formimin e specialistëve, ekspertëve të kësaj fushe, duke i pajisur me njohuritë e kualifikimet e duhura me synim plotësimin e kërkesave të tregut.</p> <p>Evidence 1.1 Statuti i UGJ Evidence 1.2 Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025 Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik Evidence 1.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Turizëm</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë i UGJ, zbaton Statutin e institucionit, hartuar në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015 dhe zhvillon veprimtarinë në përputhje me misionin dhe objektivat e tij. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit, i cili ka në përbërjen e tij 9 anëtarë të kualifikuar, për fushën e turizmit, me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe nga personel akademik i departamenteve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë. Dokumentohet kjo me CV-të e personelit akademik, si dhe nga dosjet e vetëvlerësimit. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit ofron 2 programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë të studimit.</p> <p>Evidencë 1.1 Statuti i UGJ Evidencë III.3 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e</p>	<p>Evidentohet nga institucioni se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore miratuar sipas vendimit 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022, Nr.7556/1 Prot. “Mbi Procedurën për kodifikimin e programeve të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, dhe me vendim për kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane nën kodin 63BA0311S. <i>Evidence I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për Kodifikimin e programeve FE</i>		
Konkluzione	GVJ konstaton se: Ky program studimi është në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë” 80/2015, Strategjinë Kombëtare të Arsimit dhe gjithë bazën ligjore në fuqi. Programi i studimi plotëson nevojat e kërkesat e tregut për profesionistë të tregut në fushën e turizmit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në bazë të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë, Statutit të UGJ, Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe Rregullores së Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Turizmit institucioni siguron marrëdhënie të përshtatshme bashkëpunimi, duke përcaktuar detyrat e personelit akademik dhe statusin e tyre. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik përcaktohen edhe në marrëveshjet e nënshkruara në fillim të vitit akademik mes drejtuesit të njësisë bazë dhe pedagogut lidhur me ngarkesën mësimore në auditor dhe jashtë auditorit, kontribut institucional etj. Institucioni analizon në mënyrë të vazhdueshme punën, sipas detyrave të ngarkuara dhe realizimit të tyre nga ana e personelit të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore. Bazuar në aktet rregullatore të UGJ, janë përcaktuar detyrat e personelit akademik nëpërmjet marrjes së përgjegjësive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Ndarja e detyrave, ngarkesës mësimore brenda e jashtë auditorit bëhet në mbledhjet e njësisë bazë, në takimet mes grupeve të punës si edhe përmes postës elektronike. Analiza e vazhdueshme e punës së kryer vërtetohet përmes raporteve të analizës vjetore të aktivitetit akademik e atij kërkimor të Departamentit, po kështu edhe përmes analizës së ecurisë së programit të studimit dhe dosjeve të vetëvlerësimit të punës akademike e kërkimore të çdo pedagogu.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Evidence 1.1 Statuti I UGJ</i></p> <p><i>Evidence 1.14 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2019-2020</i></p> <p><i>Evidence 1.14.2 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2020-2021</i></p> <p><i>Evidence 1.14.4 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas dokumenteve shoqërues të RVB dhe vizitës në institucion, konstatohet se Departamenti në bashkëpunim me Fakultetin kanë nënshkruar marrëveshje reciproke me institucione të rëndësishme në vend si publike edhe private në nivel universiteti dhe fakulteti, për realizimin e objektivave kryesorë të procesit mësimor e formues të studentëve. Institucioni mundëson leksione të hapura nga lektorë apo përfaqësues specialistë në fushën e programit nga institucione publike dhe private. Këto aktivitete janë në linjë me kërkesat e tregut dhe në përputhje me Strategjinë për Zhvillimin Kombëtar, duke përmirësuar edhe kurrikulat e programit të studimit. Qëllimi i këtyre bashkëpunimeve është pasurimi dhe përmirësimi i ofertës akademike dhe nxitja e kërkimit shkencor. Aktivitetet e kryera gjatë vitit akademik pasqyrohen edhe në raportet vjetore të institucionit.</p> <p><i>Evidence 1.14 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2019-2020</i></p> <p><i>Evidence 1.14.2 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2020-2021</i></p> <p><i>Evidence 1.14.4 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2021-2022</i></p> <p><i>Evidence Tabelat përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Programi Bachelor në “Turizëm”, nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale në planin mësimor.</p> <p><i>Evidence II.2 Plani mësimor i programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të</p>	<p>UGJ e në mënyrë të veçantë njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione apo biznese, në funksion të realizimit të programit të studimit. Në zbatim të marrëveshjeve, interesi ka qenë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>reciprok, si nga ana e UGJ ashtu edhe nga ana e kompanive apo e institucioneve për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme. Studentët e këtij program studimi, kanë patur mundësi të marrin informacion, apo edhe të punësohen në këto institucione. I gjithë ky proces bashkëpunimi ka qenë në qendër të analizave për përfitimet nga ky bashkëpunim. UGJ harton raporte vjetore në kuadër të përfitimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p><i>Evidence 1.14 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2019-2020</i> <i>Evidence 1.14.2 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2020-2021</i> <i>Evidence 1.14.4 Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare e UGJ për vitin 2021-2022</i> <i>Evidence Tabelat përmbledhëse</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni siguron marrëdhënie të përshtatshme bashkëpunimi, duke përcaktuar detyrat e personelit akademik dhe statusin e tyre.</i> <i>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione publike edhe private në nivel universiteti dhe fakulteti, për realizimin e objektivave kryesorë të procesit mësimor e formues të studentëve.</i> <i>Kurrikula e programit Bachelor në "Turizëm", nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Turizëm” është program studimi i ciklit të parë, organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Totali i krediteve (ETCS) është 180 ETCS. Kohëzgjatja është 3 vite akademike, me gjashtë semestra, forma e studimit me kohë të plotë, bazuar në suplementin e diplomës dhe në rregulloren e programit të studimit. Gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe.</p> <p><i>Evidence II.2 Plani mësimor i programit</i> <i>Evidence II.1 Rregullore e Studimeve në UGJ, neni 14, pika 4</i> <i>Evidence 1.5 Rregullore e programit të studimit, neni 6</i> <i>Evidence II.4 Format Diplome</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit synon të realizojë formimin e plotë për specialistët e ardhshëm në fushën e turizmit. Në programin e studimit që po akreditohet janë vendosur objektiva të qartë për lidhjen e studimeve të ciklit të parë me studimet e mëtejshme. Synim i rëndësishëm për këtë program studimi është të rrisë kompetencat profesionale të studentëve. Këtij synimi i shërben edhe përfshirja e lëndëve të ndryshme koherente që lidhen me profiling e turizmit, marketingut, menaxhim etj.</p> <p>Me anë të veprimtarive formuese të parashikuara në planin mësimor të programit të studimit, studentët pajisen me njohuritë e nevojshme në mënyrë që të ndjekin edhe studimet e cikleve pasardhëse.</p> <p><i>Evidence II.2 Plani mësimor i programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në</p>	<p>Kurrikula e programit është në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) e cila ndan lëndët në kategoritë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategoria A - Lëndë Bazë me 35 ECTS zënë rreth 19% të krediteve (brenda kufijve 15% - 20% të krediteve); ▪ Kategoria B - Lëndë Karakterizuese me 99 ECTS zënë rreth 55%

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Qap H



<p>kredite.</p>	<p>të krediteve (brenda kufijve 50% - 55% të krediteve);</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kategoria C - Lëndë Ndërdisciplinore me 29 ECTS zënë rreth 16% të krediteve (nga 12% - 15% të krediteve që parashikohen në VKM nr. 41); ▪ Kategoria D - Lëndë Plotësuese me 10 ECTS zënë rreth 10% të krediteve (5% të krediteve nga 10-15% që parashikohet në VKM); ▪ Kategoria E – Detyrime Përmbyllëse me 7 ECTS zë 5% të krediteve (brenda kufijve 3% - 5% të krediteve). <p><i>Për shkak të mospërputhjes së kategorisë D me kufirin e parashikuar nga VKM nr. 41, Njësia bazë ka propozuar riorganizimin e kurrikulës për vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Programi është i organizuar në 6 semestra dhe ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh akademike. Çdo vit akademik është i ndarë në 2 semestra me ngarkesë mesimore prej afërsisht 30 ECTS secili.</i></p> <p>Evidence II.2 Plani mësimor i programit Evidence Tabelat Përmbledhëse (tab 9) Evidence II.2.7 Vendimi I NJBPET për riorganizimin e Planit mësimor të programit të studimit</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sipas dokumentave nga institucioni dhe vizitës në UGJ, konstatohet se ky program studimi nuk parashikon zhvillim të detyruar të praktikës profesionale.</p> <p>Projekti i Diplomimit është një element i rëndësishëm i programit të studimit ku studentit i caktohet një udhëheqës i cili është kompetent për ecurinë dhe zhvillimin e projektit të kërkimit. Në fund të procesit të projektit të kërkimit, pasi mbikëqyrësi kryen vlerësimin, studenti prezanton tezën duke ju përmbajtur specifikave të Rregullores së Fakultetit dhe Rregullores së Universitetit.</p> <p>Evidence Tabelat Përmbledhëse Evidence II.2 Plani mësimor i programit</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, stafi i ftuar dhe e gjithë infrastruktura e ndërtuar dhe e mirëkruar është në mbështetje cilësore të këtij procesi mësimdhënie dhe mësimnxenie që reflektohet në kërkesën në rritje që tregu ka për këtë diplomë, e cila nga ana tjetër mbështetet dhe furnizohet me atë cka prodhojnë analizat dhe studimet e tregut duke reflektuar me një feedback të shëndetshëm në përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit mësimor.</p> <p>Marrëdhëniet me bizneset dhe institucionet efektive në tregun vendas e bën më të kërkuar këtë diplomë. Studentët pranojnë sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kriterëve shtesë universitare në Republikën e Shqipërisë. Pranimi në programin e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat i</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>cili ka përfunduar me sukses Arsimin e Mesëm të Lartë dhe plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me nenin 74 të ligjit nr. 80/2015 në Ligjin për Arsimin e Lartë. Studentët e huaj janë të detyruar të ndjekin procedurat e njohjes së diplomës dhe ekuivalencës, sipas legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Evidence II.1 Rregullore e Studimeve në UGJ</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programet e studimit në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë i përafrohet masës së caktuar të ngjashmërisë. Me Kodifikimin e programeve, ngjashmëria e përmbajtjes së programeve parashikohet të arrijë në masën e përcaktuar.</p> <p>Evidence I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FE</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Dokumentohet se sipas VKM nr 310, datë 11.05.2022 mbi “specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Udhëzimin 31, datë 15.11.2022, “Mbi procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, përcaktimi i kodeve është hartuar duke konsideruar elementët e studimit të mëposhtëm:</p> <p>a) Nivelin e programit të studimit, sipas nivelit të përcaktuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit;</p> <p>b) Kohëzgjatjen e programit të studimit;</p> <p>c) Llojin e programit të studimit;</p> <p>d) Fushën e detajuar në të cilën bën pjesë programi i studimit;</p> <p>e) Gjuhën e programit të studimit.</p> <p>Evidencë I.10 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve</p> <p>Evidence I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FE</p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>NA</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>Programi i studimit Bachelor në “Turizëm” organizohet në lëndë ose module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Sign

Signature

	<p><i>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS).</i></p> <p><i>Me anë të veprimtarive formuese të parashikuara në planin mësimor të programit të studimit, studentët pajisen me njohuritë e nevojshme për ndjekjen e studimeve të cikleve pasardhëse.</i></p> <p><i>Vihen re mospërputhje të kategorisë D me kufirin e parashikuar nga VKM nr. 41, për këtë arsye Njësia bazë ka propozuar riorganizimin e kurrikulës për vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Pranimi i studentëve realizohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë.</i></p> <p><i>Konstatohet nga dokumentacioni mbështetës i RVB-së se kodifikimi i programit është hartuar sipas kërkesave ligjore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Evidentohet se Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit është përgjegjës për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore sipas nenit 25, të Ligjit për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” Nr. 80/2015.</p> <p>Fakulteti Ekonomik në UGJ, si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit ka angazhuar gjatë vitit 2022-2023 22 personel akademik me kohë të plotë, 10 personel akademik me kontratë dhe 3 personel ndihmës akademik. FE përbëhet nga 3 njësi bazë (duke përmbushur përcaktimet ligjore përkatëse):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Administrim Publik, • Departamenti Kontabilitet- Financë, • Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit <p>Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit është njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit. Ai funksionon dhe organizohet sipas akteve rregullatore të UGJ dhe në veçanti të rregullores së departamentit.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2020-2021, Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit ka angazhuar 9 anëtarë të personelit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 7 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 3 me gradën “Doktor”, dhe 2 me titullin Msc; <p>Gjatë vitit akademik 2021-2022, Departamenti i Politikave</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>Ekonomike dhe Turizmit ka angazhuar 10 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 7 PAE, nga të cilët 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 3 me gradën “Doktor”, dhe 2 me titullin Msc; <p>Gjatë vitit akademik 2022-2023, Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit ka angazhuar 9 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 7 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor i Asociuar”, 2 me gradën “Doktor”, dhe 3 me titullin Msc; <p>Numri i personelit akademik që i përket kategorisë “Profesor” është i ulët dhe departamenti duhet të bëjë përpjekje për angazhimin e një numri më të madh pedagogësh nga kjo kategori.</p> <p>UGJ i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional duke ju përmbajtur kërkesave ligjore në vitin 2021.</p> <p>Të dhënat për Departament i Politikave Ekonomike dhe Turizmit:</p> <table border="1" data-bbox="600 869 1406 1279"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/ grada</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr.</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD.</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>7</td> <td>2</td> <td>7</td> <td>3</td> <td>7</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidencë Tabelat përmbledhëse (Tab. 1, Tab.2) Evidencë I.9 Vendim i Akreditimit Institucional periodic</p>	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	2	-	1	-	2	-	Dr./PhD.	3	-	3	-	2	-	Msc.	2	2	3	3	3	2	Totali	7	2	7	3	7	2
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-																																											
Prof. Asoc.	2	-	1	-	2	-																																											
Dr./PhD.	3	-	3	-	2	-																																											
Msc.	2	2	3	3	3	2																																											
Totali	7	2	7	3	7	2																																											
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Dokumentohet se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e këtij programi angazhon një personel ndihmës akademik me karakter mësimor për realizimin e punëve në laborator.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, Fakulteti Ekonomik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjatë vitit 2020-2021 ka angazhuar 2 personel ndihmës akademik; • gjatë vitit 2021-2022 ka angazhuar 2 personel ndihmës akademik; • gjatë vitit 2022-2023 ka angazhuar 3 personel ndihmës akademik <p>Evidencë II.6 Rregullore e FE Evidencë II.13 Rregullore e Njesisë Bazë</p>																																																

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	Evidence Tabelat Përmbledhëse			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Në bazë të dokumentave dhe sipas vizitës në institucion konfirmohet se roli i koordinatorit për programin e studimit mbulohet nga Drejtuesi i Departamentit, i cili mban komunikim të vazhdueshëm me Dekanin e Fakultetit si dhe është në komunikim të vazhdueshëm me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Drejtuesi përgatit programin e lëndëve të ofruara dhe shpërndarjen e orëve mësimore për pedagogët e departamentit në bashkëpunim me Dekanin. Pra shpërndarja e orëve dhe e lëndëve bëhet në përputhje me natyrën e lëndëve, nevojat e departamentit dhe profilizimet e stafit përkatës, të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p><i>Evidencë II.6 Rregullore e FE</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e Njesisë Bazë</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i> <i>Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit është përgjegjës për programin e studimit dhe i përmbush detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi duke angazhuar edhe personel ndihmës akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Për këtë program studimi është njësia bazë përgjegjëse, Departamenti NJBPET dhe FE disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, për strukturën dhe përmbajtjen e tij. I gjithë informacioni rreth këtij programi qarkullon, ruhet, arshivohet në bazë të akteve rregullatore të institucionit. Edhe në faqen zyrtare të UGJ mund të gjendet çdo informacion i vlefshëm për mirë funksionimin e këtij program studimi.</p> <p>Njësia kryesore dhe bazë disponojnë rregulloret përkatëse, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i Universitetit</i> <i>Evidencë II.3 Rregullore e Njesisë Bazë</i> <i>Evidencë II.2 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i	<p>Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe, në tre vite akademike të ndarë secili në dy semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Lëndët janë të ndara sipas kategorive referuar përcaktimeve ligjore. Kurrikula</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>e programit të studimit përmban 29 lëndë nga të cilat 26 lëndë të detyrueshme dhe 3 lëndë me zgjedhje. Në vitin e parë zhvillohen 10 lëndë, në vitin e dytë 10 lëndë dhe në vitin e tretë 9 lëndë dhe provimi final.</p> <p>Programi vlerësohet gjithsej me 180 kredite:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 6 lëndë/module vlerësohen me 7 kredite; ● 18 lëndë vlerësohen me 6 kredite; ● 6 lëndë vlerësohen me 5 kredite; <p>Për sa i përket orëve në auditor, program i studimit parashikon 1.164 orë në auditor, nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 630 orë në auditor gjatë vitit të parë; ● 600 orë në auditor gjatë vitit të dytë; ● 575 orë në auditor gjatë vitit të tretë. <p><i>GVJ konstaton se ngarkesa në auditor është e balancuar midis semestrave. Plani mësimor parashikon edhe 2695 orë jashtë auditorit në formën e detyrave/projekteve dhe punës individuale. Pra programi i studimit parashikon në total 4500 orë mësimore gjithsej.</i></p> <p>Evidence II.2 Plani mësimor i programit</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që synojnë këtë program studimi. Këto informacione kryesisht lidhen me kriteret e përgjithshme e specifike të pranimit, kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Në fillim të programit, studentët takohen me anëtarët e departamenteve dhe në fillim të çdo kursi ka një sesion të specifikuar hyrës të krijuar posaçërisht që pedagogët të ofrojnë një shpjegim rigoroz të planprogramit, rendin akademik të kursit, komponentëve të vlerësimit dhe afatet, literatura dhe paketat softuerike të aplikueshme dhe komponentë të tjerë të rëndësishëm siç janë specifikuar në planprograme.</p> <p><i>Evidencë II.16.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021</i></p> <p><i>Evidencë II.16.2 Kriteret e pranimit të studentëve 2020-2021</i></p> <p><i>Evidencë II.17.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022</i></p> <p><i>Evidencë II.17.2 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë II.17.5 Kuotat e propozuara 2022-2023 dhe kriteret e pranimit 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë II.20 Procedurë e transferimit në FE</i></p> <p><i>Evidencë II.20.1 Procedurë e ekuivalentimit të studimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e</p>	<p>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>leksione e seminare. Disponon edhe informacion për gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara nga MAS dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Në përgjithësi syllabuset janë të unifikuara për sa i përket objektivave, temave të lëndës së bashku me çështjet për secilën temë, vlerësimin e studentit dhe literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar.</p> <p>Syllabusi i prezantohet studentëve nga instruktori i lëndës në fillim të lëndës duke dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm rreth tematikave të lëndës, orëve në auditor dhe jashtë auditorit si dhe mënyrën e vlerësimit.</p> <p>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion, dokumentacionit mbështetës dhe verifikimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyra, projekte, ese – 20% të vlerësimit total; • Provimit përfundimtar - 80% të vlerësimit total. <p>Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar janë pjesë e syllabusit të lëndës. Syllabuset e lëndëve përgatiten nga personeli akademik në gjuhën shqipe. Ndryshimet në përmbajtjen e programit miratohen në fillim të vitit akademik dhe ndryshimet e programit të studimit arkivohen sipas rregullave në fuqi.</p> <p>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset) Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET (neni 14) Evidencë II.11.4 Dërgim në MAS për riorganizimin e planeve mësimore</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>Njësia kryesore dhe bazë disponojnë rregulloret përkatëse, rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për syllabuset e lëndëve, ku përfshihet edhe ngarkesa mësimore në leksione e seminare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Për këtë program studimi, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve si pjesë e programit, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme apo punësim të tyre.</p> <p>Në bazë të planit mësimor, lëndët bazë të detyrueshme janë lëndët që i ofrojnë studentëve njohuri e përgatitje të përgjithshme. Lëndët karakterizuese lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe pajisin me formim specifik sipas karakteristikave të tij. Lëndët ndërdisiplinore dhe /ose integruese janë të mbështetura tek lëndë të fushës kryesore të studimit. Pësha specifike që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda këtij program studimi nuk është e përcaktuar plotësisht në përputhje me aktet ligjore e nën ligjore në fuqi, gjë për të cilën janë marrë masa nga njësi bazë.</p> <p><i>Në përfundim të studimeve ky program i pajis studentët me kualifikimin e nevojshëm për të ndjekur më pas ciklin pasardhës të studimeve por edhe i përgatit ata drejt tregut të punës.</i></p> <p>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit Evidencë II.2.7 Vendimi i NJBPET për riorganizimin e Planit mësimor të programit të studimit Evidencë II.22 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Konstatohet nga dokumentacioni se lëndët/modulet shpërndarja në vite akademike e semestra, vlerësimi i lëndëve në kredite e orë mësimore, orë në auditor e punë individuale e studentëve, mundësojnë realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe programeve lëndore, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra sipas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e balancuar dhe mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në fushën e turizmit.</p> <p>Në planin mësimor lëndët janë të shpërndara në vite akademike, në semestra, në fillim paraqiten lëndët bazë, pastaj lëndët formuese në mënyrë që studentët të thellojnë njohuritë e tyre në profilin e programit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit Tabelat Përmbledhëse (Tab. 9, 10)</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Dizajni dhe lëndët e programit të studimit, dhe raporti teori kundrejt praktikës janë në përputhje me profilin e programit të studimit dhe të ngjashme me programet ndërkombëtare përkatëse. Ky program u mundëson studentëve të arrijnë dhe thellojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre në fushën e turizmit. Programi është hartuar në bazë të sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve ECTS. Ngarkesa në kredite është 30 kredite në semester dhe në total programi përmban 180 ECTS.</p> <p>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit Tabelat Përmbledhëse (Tab. 10)</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Për këtë program studimi ndarja e elementëve të programit sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritje e realizim të objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitete dhe punësim në përfundim të studimeve. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit, ky program ndërthur formimin teorik të studentëve me formimin praktik.</p> <p>Referuar planit mësimor, ndarja e orëve në auditor në leksione dhe seminare është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione – 840 orë mësimore • Seminare – 630 orë mësimore • Ushtrime/Laboratore – 285 orë <p><i>Studentëve të këtij programi u ofrohen mundësi të kryejnë mobilitete, duke qenë se veprimtaria formuese e këtij program është e ngjashme me programe të tjera të ngjashme në universitete të huaja.</i></p> <p>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit Evidencë II.4 Model Diplome Evidencë II.4.3 Suplement Diplome Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset) Evidencë II.24 Procedurë mobiliteti</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve/modulet e programit të studimit, përditësohen vazhdimisht në department dhe miratohen nga Departamenti në fillim të vitit akademik. Programet e lëndëve janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë ngarkesën semestrale të lëndës për 15 javë, të ndarë në orë leksioni, seminari, laboratorë, saktësojnë objektivat e lëndës, përfitimet nga lënda, me qëllim që studentët të marrin aftësitë e duhura profesionale, kompetencat e duhura, sipas kërkesave të tregut. Këto programe lëndësh përfshijnë edhe literaturën bazë, të detyrueshme edhe atë plotësuese.</p> <p><i>Gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se pedagogët angazhohen që nëpërmjet rasteve studimore,</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>dhe punimeve/artikujve shkencorë t'u ofrojnë studentëve njohuri sa më aktuale dhe praktike në lëndët përkatëse.</p> <p>Titullari bën kërkesë për literaturën e nevojshme dhe miratohet nga njësia bazë, synohet që syllabuset e lëndëve të përditësohen me literaturë të 5 viteve të fundit.</p> <p>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset) Evidencë II.5.4 Praktikë për miratimin e literaturës baze të detyrueshme dhe literaturës së rekomanduar</p>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Dokumentohet nga institucioni, se rezultatet e pritshme të të nxënit pas tre viteve të studimit, janë rritja e aftësive, e kompetencave, e mundësive për të gjetur punë në përputhje me shkollimin, mundësi për të vijuar më tej studimet. Një dokument i rëndësishëm që pasqyron këto përfitime është edhe suplementi i diplomës, i cili i jepet studentëve nga Fakulteti në përfundim të studimeve në dy gjuhë shqip e anglisht. Po kështu, një pasqyrim i mirë i rezultateve të pritshme bëhet edhe në analizën e ecurisë së programit të studimit.</p> <p>Evidencë II.4.3 Suplement Diplome</p>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Programi i studimit ka përmbajtjen e duhur dhe i krijon studentëve mundësi për vijimësinë e mëtejshme të studimeve, natyrisht në plotësim të kriterëve. Kërkesat në fushën e turizmit nga institucionet publike dhe private janë të vazhdueshme dhe kjo është mundësi e mirë për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në këtë program.</p> <p>Evidencë II.2 Plani mësimor i programit Evidencë II.25 Analiza e tregut të punës Tabelat përmbledhëse (Tab. 23)</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <p>Përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive të studentëve për studime të mëtejshme apo punësimin e tyre.</p> <p>Syllabuset përditësohen vazhdimisht në departament dhe miratohen nga Departamenti në fillim të vitit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit, ka për synim plotësimin e kërkesave të tregut për studentë të përgatitur në fushën e turizmit. Studimi i tregut, panairët që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, i shërbejnë këtij synimi. Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme, me qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacion për këto mundësi edhe përmes aktiviteteve të përbashkëta që zhvillon institucioni UGJ.</p> <p><i>Evidencë II.25 Analiza e tregut të punës</i> <i>Evidencë II.27 Pjesëmarrje në panair Work and Study 2022</i> <i>Evidencë II.27.1 Pjesëmarrje në panair Work and Study 2023</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Dokumentohet në aktet rregullatore se UGJ nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimarrje. Studentët vlerësojnë procesin akademik përmes plotësimit të pyetësorëve drejtuar studentëve. I gjithë ky proces i realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ndihmon institucionin të përmirësojë cilësinë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi UGJ, ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, duke zbatuar strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, pra duke përfshirë studentët në GVB. UGJ mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, konsultohet me ta rreth problematikave të programit të studimit, përmirësimit të kurrikulave, për të ndihmuar Departamentin në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, të lidhjes së formimit teorik me atë praktik, duke u referuar edhe eksperiencave të fituara tashmë në punë prej tyre. Informacioni e lidhja me studentët e diplomuar merret përmes takimeve, konferencave, mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me Alumni të këtij fakulteti e programi studimi.</p> <p><i>Evidencë I.30 Statuti i Këshillit Studentor</i> <i>Evidencë II.29.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik</i> <i>Evidencë VI.4 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e</p>	<p>Departamenti në bashkëpunim me institucione publike e private, në zbatim të marrëveshjeve me to, përmirëson, përditëson programin e studimit në përputhje me kërkesat e nevojat e tregut, në përputhje me kërkesat e institucioneve publike dhe private, duke përfshirë përfaqësues të tyre në mësimdhënie, në leksione të hapura sipas fushës së studimit të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidencë I.18 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UGJ</i> <i>Evidencë II.28 Impakt Week 2023</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<i>Evidencë II.27 Pjesëmarrje në panair Work and Study 2022</i> <i>Evidencë II.27.1 Pjesëmarrje në panair Work and Study 2023</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme me qëllim punësimin e studentëve.</i> <i>Konstatohet në aktet rregullatore se UGJ nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimarrje me anë të pyetësorëve të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar në dokumente si: rregullore e programit të studimit, rregullore e Fakultetit, rregullore e Departamentit, dhe në planin mësimor ngarkesa ndahet në leksione, seminare, laboratorë, ushtrime. Në programin e lëndës specifikohen edhe detyrimet e studentit për të shlyer lëndën si test i ndërmjetëm, provim përfundimtar, detyrë apo projekt kursi, të gjitha në shërbim të transmetimit të dijeve e njohurive tek studentët.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor Bachelor në Turizëm</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabusët)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>UGJ, përmes programit të studimit, ofron kurrikul në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të përshtatur me kushtet e tregut. Procesi i mësimdhënies kryhet nga ana e personelit akademik duke përdorur metoda alternative mësimdhënie e mësimnxënie, duke iu përgjigjur nevojave e interesit të studentëve. Gjatë zhvillimit të lëndëve sipas planit mësimor, realizohen edhe leksione të hapura nga ekspertë të fushës së arsimit, mësim në laboratore, seanca diskutimesh. Gjatë periudhës së pandemisë, mësimi u zhvillua online përmes platformave Teams, Classroom, Edumeeet. Gjithashtu, mësimdhënia është përqendruar edhe në metoda didaktike innovative duke përdorur teknologji të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë III.5 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie</i> <i>Evidencë III.1.1 Implementimi I platformës së mësimin online</i> <i>Evidencë III.1.2 Implementimi I platformës së mësimin online Edumeeet</i> <i>Evidencë III.1.3 Implementimi I platformës së mësimin online Office 365</i> <i>Evidencë III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Evidencë III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët</i>						
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	<p>UGJ përmirëson në vijimësi aftësitë e personelit akademik për mësimdhënie, apo aftësitë didaktike përmes marrjes së eksperiencave si brenda vendit edhe jashtë vendit, këto të fundit përmes shkëmbimeve të trajnimit me universitete të huaja. Bashkëpunimet janë të mbështetuara në marrëveshje të lidhura mes UGJ dhe institucioneve të tjera arsimore publike dhe private. Gjithashtu, UGJ përmirëson në vijimësi aftësitë e personelit akademik për mësimdhënie nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës, modernizimit të laboratorëve si dhe hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme innovative në mësimdhënie.</p> <p><i>Evidencë III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik</i> <i>Evidencë III.5 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie</i> <i>Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ</i> <i>Evidencë I.19 Lista e projekteve të UGJ</i> <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ</i></p>						
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p>Në UGJ personeli akademik i angazhuar në programin e studimit mban grada e tituj shkencorë duke plotësuar kërkesat ligjore në fuqi. Për realizimin e këtij programi studimi gjatë vitit akademik 2022-2023 janë angazhuar:</p> <table border="1"> <tr> <td>Profesor i Asociuar</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Doktor</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Master i Shkencave</td> <td>3</td> </tr> </table> <p>Gjatë zhvillimit të orëve të leksionit e të seminareve, lektorët zhvillojnë mësimin në mënyrë interaktive, pra duke përfshirë edhe studentët në diskutim përmes pyetjeve që drejton lektori në sallë dhe diskutimit në detaje të çështjes duke përfshirë edhe studentët në diskutim.</p> <p><i>Evidencë Tabelat Përmbledhëse (Tab. 4, Tab. 6, dhe Tab 10)</i> <i>Evidencë III.3 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik</i></p>	Profesor i Asociuar	2	Doktor	2	Master i Shkencave	3
Profesor i Asociuar	2						
Doktor	2						
Master i Shkencave	3						
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë	Dokumentohet se Departamenti përgjegjës për programin e studimit zhvillon analiza vjetore si për mësimin edhe për punën kërkimore, pasi merret opinion i të gjithë personelit akademik sipas lëndëve / disiplinave. Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në						

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>pyetësorët e shpërndarë nga NjSBC. Sugjerimet e tyre merren parasysh për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përdorimit të metodave bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p>Evidencë III.7 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Nga dokumentat dhe vizita në UGJ rezulton se janë ngritur të gjitha strukturat për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Kështu, është ngritur sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave si dhe Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me jashtë.</p> <p>Të dyja këto njësi bashkëpunojnë me Njësinë Kryesore dhe Njësinë Bazë me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe zhvillimin e metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ Evidencë I.19 Lista e projekteve të UGJ Evidencë III.5 Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie Evidencë II.26 IMPACT WEEK 2023, Gjirokastra, Albania</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni harmonizon një sërë formash të mësimdhënies dhe mësimdhënies hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative në mësimdhënie si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës dhe modernizimit të laboratorëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në</p>	<p>Konstatohet se UGJ dhe Fakulteti i Ekonomisë kanë miratuar aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në RSH”, lidhur me mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më konkretisht, në rregulloren e programit të studimit, përkatësisht neni</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>39, 40, 41, 62, 63, 64, në rregulloren e Fakultetit, neni 33, 34, 35, 38, në rregulloren e UGJ, neni 68, 81, 82, 83, në rregulloren e NJPET, neni 30, 31, 32. Gjithashtu me anë të syllabuseve të lëndëve, studentët informohen për mënyrën e vlerësimit të dijeve të tyre. Të gjitha aktet rregullatore publikohen në faqen e Web të UGJ.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor Bachelor në Turizëm</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ky informacion i rëndësishëm u jepet studentëve që ditën e parë të nisjes së lëndës, apo në leksionin e parë, kur bëhet edhe prezantimi i programit të lëndës.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në programin e studimit, vlerësimi i studentëve bëhet përmes 2 elementëve: vlerësimi për aktivizimin, për testin e parë apo të ndërmjetëm, për detyrën apo projektin e kursit dhe vlerësimi për provimin përfundimtar. Totali i pikëve të fituara nga studenti në të gjithë këta elementë, mundëson vlerësimin e studentit me notë për lëndën përkatëse. Studentët e marrin informacionin për detyrimet e tyre në lëndë përveç se nga rregulloret edhe nga lektori ditën e parë të mësimit në atë lëndë.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor Bachelor në Turizëm</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë III.12 Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>Njësia bazë dhe Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët me anë të pyetësorëve në mënyrë që studentët të kenë mundësinë dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>hapësirën e duhur për të dhënë opinione, kritike apo sugjerime mbi programin e studimit. Njësia bazë i jep një rëndësi të vecantë këtij procesi duke duke reflektuar mendimet e sugjerimet e studentëve me qëllim përmirësimin e kurrikulës.</p> <p><i>Evidencë III.6 Pyetësor studentor</i> <i>Evidencë III.7 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Institucioni mundëson përdorimin e metodave innovative për përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet: Përmirësimin të infrastrukturës së mësimdhënies duke ofruar auditor te pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe modernizimit të bazës laboratorike me qëllim zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor. Mundësinë e shkëmbimit të personelit akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme si dhe pjesëmarrjes në trajnime dhe workshope në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj. UGJ gjithashtu ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave innovative në procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ</i> <i>Evidencë I.19 Lista e projekteve të UGJ</i> <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ</i> <i>Evidencë III.2 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET</i> <i>Evidencë III.5 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posacme të testimit të njohurive gjatë vitit akademik dhe projektit përfundimtar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin</p>	<p>Dokumentohet në rregulloren e UGJ-së, rregulloren e Fakultetit, rregulloren e programit të studimit, dhe në syllabuset e lëndëve mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga ana e studentëve të këtij programi studimi. Në syllabus përcaktohet se vlerësimi i lëndës bëhet duke grumbulluar pikët e pjesëmarrjes dhe aktivizimit në mësim gjatë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>vitit akademik dhe reflektohet nota finale në provimin përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit zë 20%, kurse provimi përfundimtar 80%.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë II.13 Rregullore e NJBPET</i> <i>Evidencë II.2 Plani mësimor Bachelor në Turizëm</i> <i>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</i> <i>Evidencë III.2.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për të rritur transparencën dhe saktësinë në vlerësimin e studentëve UGJ përdor platformën Clean Score për korrigjimin e provimeve. Përgjigja e provimeve i vjen në kohë reale pedagogut, së bashku me analizë të rezultateve dhe kalueshmërisë. Kjo është mundësi e mirë për korrigjimin e provimeve që zhvillohen me alternativa, pasi siguron shpejtësi e saktësi në përgjigjet dhe vlerësimin e studentëve. Gjatë periudhës së pandemisë, UGJ ka implementuar testimin përmes platformës Microsoft Teams duke garantuar transparencë në vlerësimin e studentëve.</p> <p><i>Evidencë III.8 Marrëveshje bashkëpunimi me AADF</i> <i>Evidencë III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021</i> <i>Evidencë III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021</i> <i>Evidencë III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas legjislationit në fuqi dhe dokumentave të programit të studimit, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe rregulloret përkatëse ku mbështetet ky program studimi.</p> <p>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit zë 20%, kurse provimi përfundimtar 80%.</p> <p>Llogaritja e vlerësimin përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në rregulloren e Universitetit. Gjatë takimit të zhvilluar me studentët, GVJ konfirmoi që studentët janë të informuar mbi metodën e vlerësimin edhe nga instruktori i lëndës gjatë prezantimit në orën e pare.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Bazuar në dokumenta dhe vizitën në institucion, studentit i krijohet mundësi të ketë vlerësim të plotë përmes disa elementëve, jo vetëm me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>provim por edhe përmes detyrës apo projektit të kursit, punë laboratorike dhe provim të ndërmjetëm. Njohja e rezultateve paraprake të provimeve publikohen ne sistemin ESSE3 (Pitagora) brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.</p> <p>Studentit i jepet mundësia të rishikojë tezën dhe të diskutojë me pedagogun përgjegjës rezultatet e provimit të parë, me qëllim që të përmirësojë rezultatet në provimin përfundimtar.</p> <p>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Aktet rregullatore të universitetit si rregullorja e studimeve, rregullorja e universitetit, Kodi i Etikës dhe Syllabuset e lëndëve parashikojnë rregulla strikte në menyrë që të evitohet plagjiatura apo kopjimi gjatë kryerjes së provimeve.</p> <p>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset) Evidencë III.10 Kodi i Etikës</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët e programit të studimit, vlerësohen në përputhje me arritjet e tyre në të gjithë elementët përbërës të vlerësimit, të parashikuara në rregulloren e Fakultetit, në rregulloren e programit të studimit, dhe në syllabusin e lëndës. Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipas informimit që u është bërë studentëve për shpalljen.</p> <p>Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin.</p> <p>Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjës të njësisë bazë për të rivlerësuar rezultatit, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi se provimi i lëndës kryhet me sekretim dhe ky proces kryhet me praninë e komisionit.</p> <p>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</p>

	Evidencë III.10 Kodi i Etikës			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Rezultatet jepen në kohën e duhur, sipas informimit që u është bërë studentëve për shpalljen.</p> <p>Në këto rregullore parashikohet e drejta e studentëve për të kërkuar rishikim të provimit, apo ballafaqim me rezultatet e provimeve, nëse nuk janë të bindur për vlerësimin. Ankesa bëhet me shkrim nga ana e studentit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit.</p> <p>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</p>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Në raste kur ka ankesa edhe pas ballafaqimit të rezultateve të provimeve nga ana e lektorit me studentët, ngrihet komision tjetër provimi nga ana e përgjegjës të njësisë bazë për të rivlerësuar rezultatit, pas kërkesës së drejtuar nga studenti pranë sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi se provimi i lëndës kryhet me sekretim dhe ky proces kryhet me praninë e komisionit. Në rast se vërehen praktika që bien ndesh me rregulloren, Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani kanë të drejtë ndryshimi komisioni.</p> <p>Evidencë II.1 Rregullore e programit të studimeve në UGJ</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <p><i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nëpërmjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo provimi nga pedagogu. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo student duke përfshirë edhe procesin e ankimimit, i cili sigurohet nga aktet rregullatore të Institucionit. Këto informacione u konfirmuan edhe gjatë takimit me studentët e programit në ambientet e Institucionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Në bazë të dokumentave dhe vizitës në UGJ, konstatohet se programi i studimit është i përshtatur me kërkesat e tregut të punës, ndaj edhe i përgatit studentët për fushën e turizmit. Kjo bën që kurrikula e këtij programi studimi të synojë përgatitjen e pajisjen e studentëve me njohuri të mira teorike dhe praktike.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Evidencë II.2 Plani mësimor Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit, ka si synim plotësimin e kërkesave të tregut në fushën e turizmit, garanton zhvillimin e aftësive të studentëve në disa disiplina të ndërlidhura me ato të teknologjisë së informacionit, shkencave humane dhe komunikimit. Kështu nëse i referohemi planit mësimor, gjenden të ndërthurura disiplina sipas kategorizimit A/B/C/D. Syllabuset e lëndëve, saktësojnë metodologjinë e mësimdhënies.</p> <p>Evidencë Tabelat Përmbledhëse (Tab. 9)</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Në përfundim të lëndës (në fund të semestrit) pedagogët e lëndës realizojnë përsëritje të lëndës, ushtrimeve, rasteve, për të shqyrtuar kompetencat e studentëve të marra gjatë zhvillimit të lëndës, por dhe për të orientuar studentët për provimin përfundimtar. Departamenti shpall edhe orët e konsultimeve për çdo pedagog, po kështu edhe pushimi disa ditë për çdo provim ndihmon studentët të përsërisin lëndën. Në fund të vitit lektorët orientojnë studentët për detyrimet përmblyëse, si praktika mësimore dhe mikroteza.</p> <p>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset) Evidencë III.1.11 Zhvillimi i konsultimeve</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese</p>	<p>Në UGJ, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret e programit të studimit, studentëve u jepet mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në leksion apo duke kryer orë të ushtrimeve ose laboratorike, me studim individual si dhe realizimin e projekteve dhe detyrave të kursit. Kështu, bazuar në rregulloren e Praktikës Mësimore, në përfundim të ciklit të studimit, studentët zhvillojnë deri në një semestër praktikë mësimore. Personeli akademik i programit të studimit krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, për të krijuar mundësi të mëtejshme studimi e kërkimi shkencor, duke i mbështetur studentët për pjesëmarrje me punime të përbashkëta me pedagogët apo për të organizuar konferenca studentore.</p> <p>Evidencë II.5 Programet Lëndore (Syllabuset) Evidencë II.27 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022 Evidencë II.27.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023 Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve Evidencë I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.									
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në Departament realizohen edhe orë të hapura dhe seminare informuese në lidhje me zhvillimet e reja të teknologjisë. Për këto orë angazhohen anëtarë të Personelit akademik me kohë të plotë dhe me kontratë. Kjo ndikon në përditësimin e shpejtë të studentëve me të rejtat e fundit të teknologjisë në funksion të profesionit të tyre të ardhshëm. Temat e trajtuara në orët e hapura dhe seminarët janë të larmishme dhe mund të jenë brenda ose jashtë strukturës së programit të studimit. <i>Evidencë III.15 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore të UGJ 2019-2020</i> <i>Evidencë III.15.1 Plani i veprimtarive akademike kerkimore shkencore të UGJ 2022-2023</i> <i>Evidencë III.15.3 Plani i veprimtarisë së FE</i> <i>Evidencë I.20 Lista e mobiliteteve</i>								
Konkluzione	<i>GVJ kontaton se:</i> <i>UGJ ka struktura e mekanizma në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Baza ligjore për saktësimin e detyrimeve përmbyllëse të studentit, pra zhvillimi i provimit përfundimtar dhe punimi i diplomës është: Sipas VKM 41, datë 24.01.2018 dhe VKM 879, datë 18.12.2019, nenit 59, 60, 61, 62, 63 të rregullores së studimeve të UGJ, të rregullores së Fakultetit, nenit 11 të rregullores së programit të studimit. Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë edhe notën mesatare e cila i jep të drejtë studentit për të përgatitur dhe mbrojtur temën e diplomës. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë I.6 Rregullore e Universitetit</i> <i>Evidencë II.6 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë I.5 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët,	Evidentohet se UGJ njofton studentët përmes seancave orientuese në auditor nga pedagogët për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si gjatë vitit akademik edhe në fund të vitit për detyrimet e tyre përmbyllëse.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Veçanërisht për këto procedura bëhet fjalë edhe veprohet në zbatim të rregullores së studimeve në UGJ dhe Manualit të punimit të diplomës.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë III.11 Manuali i punimit të diplomës</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në UGJ, por edhe për këtë program studimi provimi final ose mbrojta e temës së diplomës kryhet para një komisioni të posaçëm që ngrihet me propozim të Drejtuesit të Departamentit dhe me miratim të Dekanit të Fakultetit. Teza e provimit hartohet nga anëtarët e komisionit, firmoset nga Drejtuesi i Departamentit miratohet nga Dekani i Fakultetit.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve</i> <i>Evidencë III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Departamenti në fillim të vitit të fundit akademik përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. Njësia bazë miraton temat e mundshme për t'u përzgjedhur nga studentët. Pedagogu udhëheqës orientojnë studentin për strukturën e punimit, për nxjerrjen e rezultateve, formulimin e konkluzioneve e sugjerimeve. Në fund bëhet miratimi dhe vlerësimi i punimit të diplomës së studentit nga ana e pedagogut, para se të dorëzohet tema në departament për evidentim, para mbrojtjes në komision. Caktohen komisionet e mbrojtjes së diplomave nga ana e njësisë bazë, të cilat miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore.</p> <p><i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve, neni 61</i> <i>Evidencë II.15.1 Miratimi i fushave të studimit</i> <i>Evidencë III.11 Manuali i punimit të diplomës</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>UGJ krijon mundësi për studentët për përgatitjen e detyrave të kursit gjatë vitit, por edhe për përgatitjen e punimit të diplomës, përmes laboratorëve që ka vënë në dispozicion si dhe përmes bibliotekës online.</p> <p><i>Evidencë III.2 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET</i> <i>Evidencë III.9 Informacion për Bibliotekën U-Library, Fondi i Librit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në rregulloret e institucionit, saktësohet se në përfundim të mbrojtjes së diplomës para komisionit studenti vlerësohet me note, Vlerësimi pasqyrohet në procesverbal i cili u konstatua nga vizita në institucion që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve, neni 62</i> <i>Evidencë III.11 Manuali i punimit të diplomës</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	UGJ sipas rregulloreve të miratuara në zbatim të Ligjit 80/2015, në përfundim të studimeve i pajis studentët me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). Studenti njoftohet të tërheqë diplomën dhe suplementin e diplomës, në përfundim të studimeve. <i>Evidencë II.1 Rregullore e studimeve, neni 65</i> <i>Evidencë II.4 Model diplome</i> <i>Evidencë II.4.3 Model suplementi i diplomës</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UGJ e ka të detyrueshme të ruajë dhe të arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet informacione për studentët nëse kërkohet. <i>Evidencë I.1 Statuti i Universitetit</i> <i>Evidencë III.13 Rregullore e secretaries mësimore</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse. Studenti mund të ndër marrë këtë hap vetëm në momentin që ka mbyllur të gjitha detyrimet akademike dhe këshillohet nga udhëheqësi akademik për mbylljen me sukses të temës së diplomës. UGJ pajis studentin me Diplomë dhe Suplement Diplome të miratuar nga QSHA.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Në programin Bachelor “Turizëm”, stafi akademik dhe ai ndihmës akademik i angazhuar për realizimin e tij, i përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Përsa i përket kualifikimeve shkencore të stafit akademik, në këtë program janë të angazhuar (viti 2022-2023): 17 PAE/ 3 PAK
1 staf akademik me titullin Prof Dr, 5 Prof As, 11 staf akademik me gradën Doktor dhe 3 Master shkencor.

Personeli jo efektiv i angazhuar në këtë program studimi, gjithashtu është punësuar në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të mbështetur ecurinë e mirë të programit.

Rekrutimi i stafit akademik bazohet në vendosjen dhe zbatimin e kriterëve të qarta dhe kualifikimeve që lidhen me fushën në të cilën janë përfshirë në mësimdhënie. Stafit akademik i angazhuar në këtë program studimi kanë treguar përkushtim për tu përfshirë në aktivitete shkencore dhe trajnime për të rritur nivelin e tyre të kualifikimit dhe për avancimin me titujt akademik.


Stafi akademik i programit Bachelor në “Turizëm”, merr pjesë në projekte kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe botojnë në publikime të Konferencave dhe Revistave shkencore. Nga evidencat e dorëzuara rezultojnë se stafi ka pjesëmarrje shumë të mirë në projekte ndërkombëtare, kryesisht mobilitete për mësimdhënie, por ka një numër të ulët të botimeve në Revista brenda vendit si dhe në pjesëmarrjet në Konferenca.

Personeli i angazhuar në programin e studimit Bsc në Turizëm,	Viti akademik 2022-2023		Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof Dr	1	-	1	-	1
Prof.Assoc	4	1	2	1	2	-
Dr/Doc	11	-	14	-	15	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<table border="1"> <tr> <td>Msc (Dr në proces)</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Ne total</td> <td>17</td> <td>3</td> <td>20</td> <td>4</td> <td>22</td> <td>1</td> </tr> </table> <p>RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca Anekset (tabela 6.1); Evidenca III.3 CV-të e Personelit Akademik; Evidenca I.16 Mobilitetet e zhvilluara UGJ 2020-2023; Evidenca I.14.6 Raport vjetor i veprimtarise mesimore-kerkimore te FE 2019-2020; Evidenca I.14.8 Raport vjetor i veprimtarise mesimore-kerkimore 2020-2021).</p>	Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	-	-	Msc	1	2	3	3	4	1	Ne total	17	3	20	4	22	1
Msc (Dr në proces)	-	-	-	-	-	-																
Msc	1	2	3	3	4	1																
Ne total	17	3	20	4	22	1																
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mesimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>I gjithë Personeli Akademik Efektiv që jep mësim në programin Bachelor në Turizëm, ka ngarkesën mesimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Në shpërndarjen e ngarkesës janë pasur parasysh dhe janë respektuar si ngarkesat në auditor ashtu edhe ato jashtë auditorit, në bazë të gradës shkencore, titullit akademik apo pozicionit të secilit anëtar të PAE, megjithatë vihet re një mbingarkesë e lartë te disa anëtarë të PAE.</p> <p>Vizita në Institucion e GVJ; RVB; Evidenca II.18.3 Raporti i verifikimit te kapaciteteve pritese 2023-2024; Evidenca Anekset (tabela 7, 10, 11, 12).</p>																					
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga kontratat e punësimit si dhe nga diskutimi me Personelin Akademik Efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor “Turizëm,, vihet re qëndrueshmëria e tyre në punë, jo vetëm gjatë periudhës së akreditimit, por edhe më herët. Stafit akademik i punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme janë të gjithë të pajisur me kontratat e punësimit dhe Institucion mbulon detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p> <p>Vizita në Institucion e GVJ dhe RVB; Evidenca shitesë nr. 3 Staf i jashtëm procedurë punësimi; Evidenca IV.3, Listëpagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik Janar-Maj 2023; Evidenca IV.6 Procedurë punësimi i personelit akademik në NJBPET.</p>																					

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret e përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

Rekrutimi dhe vlerësimi i personelit të NJBPET zhvillohet duke ndjekur procedurat ligjore dhe transparente në përputhje me Statutin e Universitetit të Gjirokastrës dhe Rregulloret në fuqi, të Fakultetit, Departamentit dhe vetë Universitetit.

NJBPET duke pasur parasysh nevojat për personel akademik efektiv ose me kontratë, përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike të punësimit në lidhje me strukturën, lëndët dhe programin e studimit. Dekanati, pasi verifikon saktësinë e dokumentacionit, i përcjell në Rektorat. Rektorati, gjithashtu kontrollon saktësinë e dokumentacionit dhe nëse ato janë të rregullta shpall vendin/et e lira të punës në Buletinin e Prokurimeve Publike dhe në faqen zyrtare (website) të Universitetit. Në rast të konstatimit të parregullsive nga ana e Rektoratit, dokumentacioni dhe procedura kthehet mbrapsht në Dekanat dhe Njësinë Bazë.

Njoftimi për vend të lirë pune shpallet në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik dhe në gazeta lokale duke iu përmbajtur rregullave. Në thirrjen e publikuar përcaktohet edhe procedura e metodologjia e vlerësimit të aplikimeve nga komisioni ad hoc.

Gjatë afatit të vendosur në aplikim, të interesuarit aplikojnë duke dorëzuar dosjet me dokumentet të fotokopjuara dhe noterizuara nga origjinali. Për të shqyrtuar dosjet ngrihen komisionet përkatëse nga secili departament, me propozim nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratim nga Dekani i Fakultetit përkatës. Komisioni, ka në përbërje anëtar të kualifikuar dhe me përvojë të gjatë në mësimdhënie, ku tre përfaqësues janë nga Departamenti, (një prej tyre Përgjegjësi i Departamentit), Dekani (kryetar i komisionit ad-hoc) dhe 1 përfaqësues nga Rektorati. Komisioni shqyrton kriteret e caktuara në Rregulloren e Universitetit të Gjirokastrës, si dhe kriteret e veçanta në varësi të departamentit, përpilon tabelën e pikëzimit të aplikantëve dhe harton listën e renditjes së tyre. Komisioni përpilon procesverbalin me renditjen përfundimtare të kandidaturave dhe ia përcjell Rektorit, i cili miraton përzgjedhjen. Kandidatët kanë të drejtë të ankohen brenda dy ditëve dhe nëse ankimimi merret parasysh, rifillon procedura me një komision të ri ad-hoc. Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike dhe Administrative në bashkëpunim me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit hartojnë kontratat e punës për personelin e përzgjedhur.

Vizita e GVJ në Institucion;
Evidenca 2. Rregullore e brendshme e UGJ;
Evidenca IV.6 Procedurë punësimi i personelit akademik në NJBPET; Evidenca 14. Rregullore për Punësimin dhe Përzgjedhjen e Stafit Akademik dhe atij Adiministrativ në UGJ.

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e

Nga vizita e GVJ në laboratorët e Universitetit të përdorura nga studentët dhe dokumentacioni i dorëzuar vihet re se Personeli

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>ndihmës akademik realizon detyrën për mirëfunksionimin e laboratorëve me kompjuter si dhe për të ndihmuar studentët që përdorin laboratorin për realizimin e detyrimeve të tyre. Për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve e pajisjeve përkatëse, në NJBPET është i angazhuar 1 (një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor, i cili nga nga kontrolli i dosjes dhe CV-së përkatëse, rezulton se zotëron aftësitë e nevojshme profesionale për këtë pozicion pune.</p> <p><i>RVB dhe Viziat në Institucion e GVJ-së;</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”;</i> <i>Evidenca I.2. Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025;</i> <i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër;</i> <i>Evidenca II.13. Rregullorja e NJBPET;</i> <i>Evidenca I.11. Organograma UGJ;</i> <i>Evidenca I.12. Organograma FE;</i> <i>Evidenca III.3. CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik;</i> <i>Evidenca II.12. Rregullore e punësimit të personelit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Në UGJ funksionon Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike Administrative (DSHNA) e përbërë nga Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelti dhe Sekretari- protokoll. Kjo strukturë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të Personelit Akademik, Ndihmës-akademik dhe Administrativ, sipas Rregullores së saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të dhënat rreth veprimtarisë shkencore të personelit akademik ruhen dhe përditësohen nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe i Marrëdhënive me jashtë Në vizitën e GVJ-së në Institucion dhe vëzhgimi me zgjedhje rastësore të dosjes së një pedagogu të brendshëm dhe një të jashtëm, rezultoi se dosjet e tyre dokumentacion të plotë (CV, kontratë punësimi, diploma, certifikata, certifikata trajnimesh, listë botimesh, listë të konferencave, etj). Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik rezulton se personeli ka formim akademik të fushave që mbulon.</p> <p><i>Vizita në institucion-takimi me drejtues së Zyrës së Burimeve Njerëzore;</i> <i>Dosje të pedagogëve;</i> <i>Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në Turizëm, nuk janë parashikuar orë mësimore të praktikës profesionale, megjithatë, Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me Bashkinë si dhe aktorë të tjerë të sektorit privat,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>për të mundësuar realizimin e temave të diplomave të studentëve. Disa nga Institucionet publike dhe private, me të cilat bashkëpunon NJBPET janë: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë, Hotel Çajupi etj.). Këto Institucione sigurojnë vënien në dispozicion të studentëve të personelit të duhur e të kualifikuar për instruktimin dhe udhëheqjen e studentëve gjatë realizimit të punimit të diplomës ose të veprimtarive të tjera, në përputhje me programin.</p> <p><i>Evidenca II.2. Plan mësimor 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.18. Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në Planin mësimor të prgramit të studimit Bachelor në Turizëm, nuk janë planifikuar të zhvillohen orë mësimore të praktikës profesionale. <i>GVJ sugjeron rishikimin e programit dhe parashikimin e praktikës profesionale të studentëve në Institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime në fushën e Turizmit dhe që janë potencial për punësimin e tyre në të ardhmen.</i></p> <p><i>Evidenca II.2. Plan mësimor 2021-2022;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se ajo mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies për programin Bachelor "Turizëm". GVJ shpreh vlerësimin se ky standard Përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në</p>	<p>Nga vizita në Fakultetin Ekonomik të UGJ-së dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se UGJ zotëron hapësirat e mjaftueshme në përputhje me standardet shtetërore për zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë të rregullt. FEUGJ ka hapësira të mjaftueshme dhe cilësore në funksion të procesit mësimor të programit të studimit Bachelor në Turizëm.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Auditorët e FE-së kanë pajisje teknologjike të përshtatshme për zhvillimin e orëve mësimore (leksione dhe seminare) si për të realizuar punët në grup, diskutimet dhe stimulimet e rasteve studimore etj. Në mjediset e Fakultetit sallat janë të pajisura me projektorë, ka mbulim wifi për tu përdorur si nga pedagogët ashtu edhe nga studentët. Për rritjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis vetë studentëve dhe student-pedagog është në funksionim platforma Teams.

Tre godinat ku zhvillon aktivitetin e tij Universiteti i Gjirokastrës kanë sipërfaqe të konsiderueshme, janë ndërtuar me materiale cilësore që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e jo akademik. Godinat plotësojnë standardet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë për zhvillimin e mësimin. Vendodhja e godinës në qendër të zonës urbane lehtëson arritshmërinë e saj nga studentët dhe personeli i punësuar, por nuk garanton qetësinë dhe eliminimin e zhurmave plotësisht. Ndriçimi i sallave është shumë i mirë, me dritare të mëdha që mbulojnë me dritë natyrale 15-20% të sipërfaqes së dyshemesë së tyre dhe lartësia e tyre është deri në 3 metra.

UGJ ka sistem për mbrojtjen nga shkarkesat atmosferike si dhe një sistem për mbrojtjen kundra zjarrit. Çdo godinë ka sinjalizues të tymit dhe në hollet e tyre ka të instaluar bombola kunra zjarrit dhe hidrante, të shoqëruar me sinjalistikën përkatëse në rastet kur nevojitet përdorimi i tyre.

Pedagogët kanë zyrat e tyre të pajisura me kompjutera si dhe studentët kanë hapësira të dedikuara për ata për përdorim kompjuterash, sallë leximi, bibliotekën, kancelarinë, etj. Në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave, Institucioni ka siguruar sisteme të ajrit të kondicionuar, ndërkohë që Godinat A, B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar. UGJ disponon edhe disa burime alternative të energjisë elektrike (një gjenerator në Godinën A). Uji është siguruar në të tre godinat e Universitetit pa ndërprerje.

UGJ dhe NJBPET kanë mjedise të përshtatshme për kryerjen e veprimtarive mësimore dhe në përputhje me natyrën e programit të studimit Bachelor në Turizëm dhe me ligjin dhe vkm-të në fuqi. Për mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve kompjuterike angazhohet stafi i degës së IT-së. Ata sigurojnë edhe përshtatjen e programeve kompjuterike sipas kërkesave të departamentit.

Vizita e GVJ në UGJ;

Evidenca II.18.3 Raporti i kapaciteteve pritese viti akademik 2023-2024; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ;

Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse: Mjediset e Fakultetit/Njesive Baze (Tabela 16);

Evidenca IV.10.1. Leje Higjieno-sanitare;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Qapit

	<i>Evidenca IV.10.2. Certificate per sigurinë nga zjarri.</i>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Në Fakultetin Ekonomik të UGJ-së, mjediset mësimore ku zhvillojnë procesin mësimor studentët e programit Bachelor “Turizëm” garantojnë realizimin e procesit mësimor. Mësimi zhvillohet në Godinën A të Universitetit të Gjirokastrës.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me paisjen e sallave dhe laboratorëve me sistemin e projektimit digjital, përfshirë edhe të gjitha mjetet e tjera audio dhe video. Laboratorët janë të paisur me kompjutera, priter/fotokopje/skaner, projektor. Laboratorët e Institucionit janë me një numër të konsiderueshëm kompjuterësh që të mundësojnë çdo student për të punuar personalisht. Në kompjuterët e laboratorëve janë të instaluar programet SPSS dhe Eviews që studentët të kenë mundësi të aplikojnë njohuritë e tyre direkt. Stafi akademik dhe jo akademik ka zyra të përshtatshme dhe të pajisura me mjete teknologjike për tu përgatitur dhe realizuar procesin mësimor me anë të metodave dhe teknologjisë bashkëkohore.</p> <p><i>Vizita e GVJ në UGJ; RVB; Evidenca II.18.3 Raporti i kapaciteteve pritese viti akademik 2023-2024; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ; Evidenca Aneks tabelat përmbledhëse: Mjediset e Fakultetit/Njesive Baze (Tabela 16).</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në Fakultetin Ekonomik, GVJ vizitoi laboratorët që ka në dispozicion Programi Bachelor në Turizëm.</p> <p>NJBPET ka në dispozicion për procesin mësimor katër laboratorë të Informatikës (1 në Godinën A dhe 3 në Godinën B, ku ka kompjutera, rrjet kompjuterik, wi-fi, Internet dhe videoprojektor. Sigurimi i rrjetit wi-fi të internetit si për pedagogët edhe studentët është një avantazh për Institucionin dhe për cilësinë e mësimdhënies. Laboratorët e Informatikës ofrojnë kushtet e përshtatshme për plotësimin e moduleve teorik dhe të objektivave formues të programit të studimit. Ndër programet e përshtatshme për studentët dhe analiza statistikore, në PC-të e laboratorëve janë instaluar Eviews dhe SPSS.</p> <p>GVJ vizitoi edhe salla të tjera leksioni ose seminari dhe konstatoi se ato janë të pajisura me video projektorë, whiteboard etj., të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca III.2. Inventari mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET; Evidenca II.18.3 Raporti i kapaciteteve pritese viti akademik</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Qapit

	2023-2024; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ; ANEKS-TABELAT PERMBLEDHESE Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ vizitoi laboratorët e Fakultetit Ekonomik dhe konstatoi praninë e kompjuterëve në secilin prej tyre dhe personelin ndihmës akademik përgjegjës për mirëmbajtjen e tij dhe për të asistuar studentët në problematikat që hasin. Kompjuterët e laboratorëve janë të lidhur në rrjetin LAN dhe garantojnë realizimin e orëve mësimore. Çdo student ka mundësi të praktikojë njohuritë e marra edhe jashtë orareve mësimore. Vizita e GVJ në Institucion; RVB; Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ; Evidenca III.2. Inventari mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se ai disponon mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik, të veçantë për programin Bachelor "Turizëm". GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.3 IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse që vihet në dispozicion të studentëve të programit Bachelor "Turizëm" është në gjuhën shqipe (cikël leksionesh dhe tekstet mësimore bazë) dhe në gjuhën angleze (materiale shtesë). Ajo gjendet si në formë fizike ashtu edhe në formë digjitale në bibliotekën e Fakultetit Ekonomik. Nga vizita në këtë Bibliotekë, GVJ konstatoi gjendjen shumë të mirë të mjediseve të bibliotekës, ambjenteve për të lexuar dhe sistemimi i librave dhe materialeve të tjera në raftë. Gjatë vizitës GVJ u njoh me hapësirën dedikuar titujve të librave për shfrytëzim nga studentët e Bachelor "Turizëm" dhe konfirmoi që ato janë pasuruar dhe ishin në shërbim të natyrës së lëndëve që zhvillohen në këtë program. Një pjesë e kësaj literature ishte siguruar nga

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>bashkëpunimet e departamentit me universitete të tjera perëndimore, sidomos ato amerikane. Përveç literaturës së botuar, studentët kanë në dispozicion ciklet e leksioneve të përgatitura nga pedagogët sipas lëndëve përkatëse, të cilat përditësohen vazhdimisht. Biblioteka siguron edhe abonime dhe shfrytëzim të literaturës digjitale në shqip dhe në gjuhë të huaj.</p> <p>Në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të Fakultetit Ekonomik të UGJ-së janë 3 salla leximi me kapacitet 53 vende gjithsej. UGJ siguron edhe abonime në Biblioteka online si JSTOR, U-Library si dhe abonime në disa revista shkencore, kryesisht amerikane. Literatura bazë dhe ndihmëse propozohet nga anëtarët e personelit akademik, shqyrtohet dhe aprovohet nga NJBPET dhe pasqyrohet në programet lëndore të programit të studimit.</p> <p><i>Në RVB, përmenden Evidencat II.5; II.5.1 dhe II.5.2, të cilat nuk janë ngarkuar në sistemin e ASCAL-it).</i></p> <p><i>RVB;</i> <i>Vizita në institucion e GVJ;</i> <i>Evidenca I.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 22;</i> <i>Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Turizëm, Neni 20;</i> <i>Evidenca II.5.4 Miratimi i literaturës hazë në NJBPET 2020-2021;</i> <i>Evidenca IV.13.1 Raportime nga biblioteka për Departamentin</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Biblioteka e UGJ-së pasurohet vazhdimisht me literaturë të re falë projekteve ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve me universitete perëndimore dhe amerikane. Ato gjenden si në formatin hard-copy, ashtu edhe në atë digjital. NJBPET, paraqet propozimet e saj për përditësimin e literaturës me botimet e viteve të fundit, të cilat miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. Gjithashtu, Biblioteka paraqet kërkesat për pasurimin e fondit çdo fillim viti, përpara miratimit të buxhetit. Fondi i Bibliotekës pasurohet edhe me dhurime nga organizata dhe Unversitete të huaja.</p> <p>Sipas RVB, syllabuset përditësohen çdo vit duke u bazuar në literaturë shqip dhe të huaj të viteve të fundit, megjithatë kjo nuk rezulton në të gjitha syllabuset e dorëzuara.</p> <p><i>GVJ sugjeron që syllabuset të përditësohen me literaturën e viteve të fundit si dhe disa prej tyre të rregullohen sipas Vendimit nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Evidenca IV.13.1 Raportime nga biblioteka për Departamentin; Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit.</i></p> <p><i>Evidenca: Viti parë 2022-2023</i></p> <p><i>Evidenca: Viti dytë 2022-2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një Bibliotekë me një koleksion të pasur librash, periodikë, material të tjera me një fond prej: 5400 Tituj dhe botime shkencore në shqip dhe gjuhë të huaj; Revista dhe periodikë shkencor 26 tituj; Monografi shkencore 1140 tituj; Libra në vëllime 62000 tituj etj. Përveç fondit fizik, që ndodhet në Bibliotekën e UGJ-së, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekat online si U-Library, JSTOR etj. Ky fond i pasur, sidomos elektronik është arritur pasi kryhet digjitalizimi i vazhdueshëm i skedarëve dhe literaturës që është aktualisht në Bibliotekë ose asaj që shtohet.</p> <p><i>Në dokumentet e dorëzuara rezulton se në dy vitet e fundit nuk ka pasur fond të parashikuar dhe të shpenzuar për pasurimin e Bibliotekës fizike të UGJ-së. GVJ sugjeron, që të mbahet në vëmendje parashikimi i fondit dhe përdorimi i tij për pasurimin e përvitshëm të Bibliotekës me tituj të rinj.</i></p> <p>GVJ, gjatë vizitës dhe takimit me punonjësit e Bibliotekës konfirmoi ekzistencën e 3 sallave të leximit. Sallat plotësojnë kushtet për një mjedis të qetë dhe të përshtatshëm për lexim e studim, si dhe janë të pajisura me mjete audio vizuale dhe teknologjike për lehtësimin e punës së tyre.</p> <p>Në bibliotekë ofrohet mundësia që studentët të kërkojnë materiale online në kompjuterat e sallave, të përdorin sallat e leximit etj. Çdo student ka kartelën (skedën) personale të Bibliotekës.</p> <p><i>Në dokumentet e dorëzuara, është ngarkuar vetëm një model i paplotësuar i skedës së studentit. Do të ishte mirë të ishte edhe një model i plotësuar i tij.</i></p> <p>RVB; Vizita e GVJ në bibliotekë; Evidenca III.9. Informacion për Bibliotekën U-Library, Fondi i librit; Evidenca IV.14. Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit;</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e</p>	<p>Në Bibliotekë ofrohet mundësia për çdo student që të kërkojë materiale online në kompjuterat e sallave, të përdorin sallat e leximit, të cilat janë 3 në total me një kapacitet të përgjithshëm prej 53 vendesh, të përdorin mediatekën etj.</p> <p>Në dispozicion të studentëve janë disa fondeve librash dhe materiale të tjera mësimore në formë digjitale dhe media të ndryshme. Fond i veçantë i Bibliotekës është ai i përfutur nga bashkëpunimi me Ambasadën Austriake në Tiranë, nga e cila janë përfutur rreth 14,000</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>libra dhe periodikë dhe material në cd/dvd. Gjithashtu, nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi ekzistencën e fondit të librave të blerë me buxhetin e UGJ-së si dhe nga dhurimet nga Akademia e Shkencave, Akademia e Studimeve Albanologjike, Universiteti i Prishtinës etj.</p> <p><i>Vizitë e GVJ në IAL; Takim i GVJ me stafin akademik të programit Bachelor në Turizëm; Takim i GVJ me studentët; Evidenca IV.13.1 Raportime nga biblioteka per departamentin Evidenca III.9 Informacion për Bibliotekën online U-Library, Fondi i librit; Evidenca IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe programe ku studentët mund të aksesojnë online literaturë në funksion të programit mësimor. Interneti falas në këtë mjedis krijon kushte të favorshme për një studim online, mundëson konsultimin me materiale të ndryshme shkencore si dhe të mësuarin në distancë.</p> <p>Biblioteka ka një fond shumë të pasur për tu shfrytëzuar online të përfituar me mbështetjen e MAS. Studentët dhe stafi akademik kanë mundësi të shfrytëzojnë fondin online të bibliotekave U-Library dhe JSTOR në çdo kohë dhe vend. Për të lehtësuar përdorimin e Bibliotekës online, në websiten e UGJ-së gjendet Manuali i përdorimit të saj. Shfrytëzimi i Bibliotekave online shton mundësitë për shfrytëzimin e literaturës në gjuhë të huaj dhe ndikon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Vizita e GVJ në Bibliotekë; Biblioteka online (https://uogj.edu.al/biblioteka-online/); Evidenca III.9 Informacion për Bibliotekën online U-Library, Fondi i librit; Evidenca IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e hapur për studentët nga e hëna në të premte në orarin 08:00 – 19:00. Studentët mund të përdorin gjithë fondin dhe mjediset e bibliotekës pa pagesë dhe në oraret e përshtatshme për ta. Studentët mund të aksesojnë fondin digjital në çdo moment dhe vend.</p> <p><i>Vizitë e GVJ në IAL; Biblioteka online (https://uogj.edu.al/biblioteka-online/); Evidenca IV.14.1 Bibloteka, Manuali i përdorimit.</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të</p>	<p>Fondi i Bibliotekës pasurohet vazhdimisht me literaturë dhe personeli</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>i punësuar në të përpiqet vazhdimisht për të rritur aksesimin e studentëve dhe profesoratis në bibliotekat online si dhe për shfrytëzimin e mjediseve dhe literaturës fizike. Drejtuesi i njësisë bazë bashkëpunon me punonjëset e bibliotekës për monitorimin e vazhdueshëm të shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, në vizitën në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat dëshmonin shkallën e mjaftueshme të shfrytëzimit. Numri i personelit të punësuar në Bibliotekë (4 gjithsej) që mund të konsiderohet jo shumë i mjaftueshëm për të përballuar nevojat e studentëve.</p> <p>Vizita e GVJ në Institucion; Takimi me Drejtuesen e Njësisë Bazë dhe Drejtuesen e Bibliotekës; Takimi me studentët; Evidenca IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës https://uogj.edu.al/biblioteka-online/</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka regjistron në mënyrë periodike dhe raporton për cilësinë fizike të librave dhe materialeve në formatin hard copy dhe të fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të studentëve dhe pedagogëve, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe online si dhe të sallave të studimit). Oraret e punës së Bibliotekës, gjatë të cilave punonjësit u përgjigjen nevojave të përdoruesve shpallen në mjediset e Institucionit. Orari normal i punës për Bibliotekën është nga e hëna deri në të premte nga ora 08:00 – 19:00.</p> <p>Nga vizita në Bibliotekë dhe takimi me punonjësit e saj, GVJ konstatoi shfrytëzim të konsiderueshëm si të materialeve ashtu edhe të mjediseve të saj.</p> <p>Vizita e GVJ në Bibliotekën e UGJ-së; Takimi me punonjësit e Bibliotekës; Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit; Evidenca IV.13.1 Raportime nga biblioteka për Departamentin. Evidenca IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar deri në një farë mase në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme) për programin Bachelor në "Turizëm". Sipas</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>evidencave të dorëzuara, rezulton se Fondi nuk është pasuruar me literaturë në dy vitet e fundit akademike, si dhe numri i personelit të Bibliotekës është relativisht i ulët, për tu shërbyer studentëve dhe stafit akademik në kohë dhe me cilësi. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>UGJ ka faqen e saj elektronike me adresë https://uogj.edu.al/, në të cilën vendosen informacione të ndryshme mbi ecurinë e Universitetit, Fakulteteve si dhe njoftimet, aktivitetet, oraret dhe datat e provimeve etj. Për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe stafit akademik përdoret Platforma elektronike Pitagora me adresë https://uogj.pitagora.rash.al/login. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve dhe pajisjen e tyre me llogari në Pitagora duke i vendosur një username (emër përdoruesi) dhe password-in (fjalëkalimin, të cilin studenti mund ta modifikojë). Përveç platformës Pitagora në UGJ për shërbimet e ndryshme të sekret</p> <p>Nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore dhe takimi me sekretaret u kontrolluan regjistrat themeltar të studentëve me të dhënat që vërtetojnë regjistrimin e studentit, numrin e matrikullimit dhe deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. Regjistrat ishin të shkruar qartë, por u vune re pasaktësi të në dy nga regjistrat e kontrolluar. <i>GVJ sugjeroi sekretarinë për të rregulluar regjistrat me të dhëna të sakta dhe përditësimin e tyre.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> https://uogj.pitagora.rash.al/login; Evidenca III.13. Rregullore e sekretarisë mësimore; Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3.</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit	Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademi dhe administrativ në UGJ, realizohet nga Drejtorja e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative, nëpërmjet sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari Protokol. Në FE dhe NJBPET ruhen dokumentacionet përkatëse në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>lidhje me personelin akademik si: ngarkesa vjetore mësimore; marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, programet lëndore etj. Baza e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademi dhe kërkimor administrohet nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe i Marrëdhënieve me Jashtë.</p> <p><i>Vizitë e GVJ në Institucion; RVB; Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA; Evidenca 15. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UGJ disponon sistem menaxhimi të brendshëm PITAGORA që siguron akses në mësimdhënie për personelin akademik, ndihmës akademik dhe studentët. Në këtë platformë ata kanë mundësi të hapin dhe përdorin informacione dhe dokumente të ndryshme. Sipas RVB-së, në Platformën PITAGORA, personeli akademik dhe ndihmës akademik kanë mundësi të përdorin llogaritë e tyre, ku janë të dhëna mbi lëndët mësimore, sezonet e provimeve, oraret e tyre, lista e studentëve të regjistruar, procesverbale provimi etj. Ndërkohë studentët kanë mundësi të shohin të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që frekuentojnë, vlerësimet në provime etj. Krahas sistemit PITAGORA akses në informacion realizohet edhe nëpërmjet website të UGJ. Këtë GVJ e konfirmoi duke hyrë në adresën https://uogj.edu.al/. GVJ nuk ka akses në sistemin e brendshëm informatik dhe nuk mund të shprehet për informacionin që përmban dhe shpërndalet studentëve dhe pedagogëve.</p> <p><i>Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore; Takim i GVJ me studentët dhe stafin akademik; https://uogj.pitagora.rash.al/login; https://uogj.edu.al/</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sipas RVB dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar platformën online, sistemin Pitagora, ku çdo student dhe pedagog kanë llogarinë e tyre dhe marrin informacione sipas nevojave. Sipas dokumentacionit studentët marrin informacion në lidhje me provimet, vlerësimet nga pedagogët gjatë semestrit dhe notën përfundimtare etj. Pedagogët dhe studentët përdorin platformat online dhe për komunikim interaktiv si dhe përdorim të folderëve të përbashkët si: Microsoft Office 365, Microsoft Teams etj. Këto platforma janë përdorur shumë gjatë pandemisë, për zhvillimin e mësimin online, por</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>vazhdojnë të përdoren edhe aktualisht për ndërveprim dhe konuminkim më të shpejtë midis pedagogëve dhe studentëve, konsultimet për diplomat etj.</p> <p><i>Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore;</i> <i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3;</i> https://uogj.pitagora.rash.al/login https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/; <i>Evidenca III.1.4. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;</i> <i>Evidenca III.1.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët.</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm PITAGORA, Esse3, Microsoft Teams etj. mundëson monitorim në kohë reale të informacionit si për aktivitetin e kryer nga personeli akademik lidhur me procesin mësimor ashtu edhe për veprimatrinë e kryer nga personeli administrativ dhe ndihmës administrativ. Sipas RVB-së, me këto sisteme mundësohen edhe raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin e vendosjes në sistem të vlerësimeve nga personeli akademik etj. Gjithashtu, në Institucion janë instaluar kamera dhe sisteme sigurie për të garantuar dhe raportuar në kohë reale për sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve të ofruara nga personeli administrativ.</p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>Takimi me Përgjegjës të Njësive bazë, studentët dhe sekretarët;</i> <i>RVB;</i> https://uogj.pitagora.rash.al/login; <i>Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3;</i> https://uogj.pitagora.rash.al/login https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/; <i>Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA;</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra</p>	<p>GVJ kontrolloi faqen e institucionit referuar adresës në RVB dhe konstatoi publikimin e aktiviteteve të realizuara nga institucioni në kuadër të përmbushjes të programit Bachelor në Turizëm. Informacioni është në gjuhën shqipe dhe angleze.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




prej tyre është gjuha shqipe.	https://uogj.edu.al/			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin Bachelor në Turizëm. GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Institucioni UGJ harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të tij nga njësia bazë përgjegjëse për programin Bachelor në Turizëm.</p> <p>Projekt buxheti vjetor hartohet nga Administratori i UGJ-së, mbi bazën e propozimeve nga Njësitë Kryesore dhe Njësitë Bazë, të mbështetura na Planin strategjik të Universitetit të Gjirokastrës dhe Planin buxhetor afatmesëm. Projekt buxheti kalon miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim nga Senati Akademik. Më pas Buxheti i detajuar përcillet për menaxhim në Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe delegohet në varësi të kërkesave të Njërive kryesore e bazë.</p> <p>RVB; Evidenca IV.16. Propozim buxheti NJBPET; Evidenca IV.16.5. Propozim buxheti njësia kryesore; Evidenca I.2. Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025 – Kreu: Financat dhe Burimet Financiare Evidenca IV.16.4. Projekt buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023 -2025.</p>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe	<p>Në faqen online të UGJ në kategorinë Transparenca/Raport Auditit dhe Buxheti janë dokumentet me raportet financiare dhe Detajimet e buxheteve sipas viteve. Nga kontrolli i kësaj faqe, GVJ konstatoi se nuk janë hedhur rregullisht Raportet financiare, të cilat janë deri në vitin 2016 dhe Dokumenti i fundit me Detajimet e buxhetit është për vitin 2020.</p> <p>Në planin e financimit Institucional janë të përfshira financimet e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve mësimore,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>shpenzimet e ndryshme për shtimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjisë për mësimdhënie, shpenzimet për pasurimin e Bibliotekës dhe nevoja të tjera, grantet vendase ose të huaja, projektet dhe zëra të tjerë.</p> <p><i>GVJ i sugjeron UGJ-së, të përditësojë informacionin me të dhënat e viteve të fundit dhe të shtojë dokumentacionet rregullisht, për të siguruar transparencë të plotë.</i></p> <p><i>Evidenca IV.16.1. Raporti vjetor financiar për vitin 2020;</i> <i>Evidenca IV.16.2. Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3. Raporti vjetor financiar për vitin 2022;</i> <i>Evidenca Aneksat: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UGJ dëshmon se vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe efikasitetin e financimit të tij. Raporti Financiar Vjetor hartohet nga Drejtoria e Shërbimeve Universitare sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe paraqet në mënyrë të detajuar të ardhurat dhe shpenzimet e Institucionit. Institucioni nuk ka të dokumentuar auditim të brendshëm periodik, por vetëm auditim nga KLSH dhe MAS.</p> <p><i>GVJ sugjeron, që Institucioni të kryejë auditim të brendshëm periodik në aspektin financiar.</i></p> <p><i>RVB;</i> <i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>Evidenca IV.16.2. Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3. Raporti vjetor financiar për vitin 2022</i> <i>Evidenca IV.17. Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve;</i> <i>Evidenca IV.17.1. Raport MASR Audit 2018;</i> <i>Evidenca IV.17.2. Raporti MAS Audit 2021.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në Raportet financiare të hartuara nga Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori i UGJ-së raportohet për masën e realizimit të buxhetit të miratuar në vitin paraardhës. Në to përshkruhen në vlerë numerike masa e shpenzimeve të kryera për paga, orë mësimore, për sigurime shoqërore e shëndetësore, mbi ngarkesë mësimore, pagat e personelit akademik të ftuar, shtesa funksionesh akademik, bursa dhe parashikohen shpenzimet për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>Evidenca IV.16.1. Raporti vjetor financiar për vitin 2020;</i> <i>Evidenca IV.16.2. Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3. Raporti vjetor financiar për vitin 2022.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Çdo njësi bazë përgatit dhe dorëzon kërkesat buxhetore në fillim të vitit akademik. Në bazë të kërkesave dhe realizimeve hartohet raporti financiar për vitin paraardhës.</p> <p>GVJ nuk gjeti asnjë dokument për Planin financiar afatmesëm ose afatgjatë, pavarësisht se Plani afatmesëm përmendet si pjesë e Evidencës IV.16.4. Në këtë dokument gjendet vetëm Plani financiar i vitit 2023.</p> <p><i>Evidenca IV.16.1. Raporti vjetor financiar për vitin 2020;</i> <i>Evidenca IV.16.2. Raporti vjetor financiar për vitin 2021;</i> <i>Evidenca IV.16.3. Raporti vjetor financiar për vitin 2022;</i> <i>Evidenca IV.16.4. Projekt buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023 -2025.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin Bachelor në “Turizëm”. Gjithashtu konstaton se, në faqen online raportet financiare dhe ato për plan buxhetet nuk janë të viteve të fundit. GVJ gjithashtu konstaton se nuk kryhet auditim i brendshëm financiar, por vetëm raportim të gjendjes dhe efikasitetit financiar si dhe nuk ka plan financiar afatmesëm ose afatgjatë. Mbështetur në sa më sipër GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe</p>	<p>Programi Bachelor në “Turizëm” zhvillohet në përputje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e UGJ-së, me rregulloren e Studimeve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

Universtrare në UGJ, rregulloren e FE në UGJ dhe rregulloren e Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Turizmit.

Rregullorja e UGJ-së për studimet universitare është dokumenti në të cilin rregullohet zhvillimi i studimeve në këtë Universitet. Në të përcaktohen qartë të gjitha njësitë, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të mësimdhënies në çdo njësi kryesore dhe bazë. Kjo rregullore i bashkangjitet dokumenteve të tjera të UGJ-së dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t'u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni.

Rregulloret shkojnë deri në nivel programi dhe kjo ndikon në përmirësimin e cilësisë së mësimin dhe adresimin e problematikave specifike për çdo program.

Evidenca I.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë;

Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë;

Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, UGJ;

Evidenca II.13. Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit;

Evidenca II.19. Baza ligjore për aplikimet dhe regjistrimet në IAL;

Evidenca II.19.1. Baza ligjore QSHA dhe RASH për pranimet e reja;

Evidenca II.18. Vendim SA për kuotat 2023-2024 dhe kriteret e pranimit 2024-2025

Evidenca II.4. Model diplome Bachelor në Turizëm

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.

Referuar Statutit të Universitetit, Rregullores së Institucionit, të Njësisë Kryesore dhe të programit të studimit si dhe evidencave të tjera shoqëruese strategjike dëshmohet se një ndër parimet e funksionimit të UGJ-së lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në programin Bachelor në Turizëm. Referuar dokumentacioneve dhe RVB-së, përcaktohet se studimet në këtë program mund të ndiqen edhe nga shtetas të huaj, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe ligjeve në fuqi.

Rregulloret përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga pranimi, regjistrimi dhe deri në përfundim të studimeve, gjë që garanton një proces transparent dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe studentët. Në faqen zyrtare online të Institucionit publikohen informacione në lidhje me kriteret dhe kuotat e pranimeve për çdo vit akademik.

Evidenca I.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë;

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër;</i> <i>Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër;</i> <i>Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, UGJ;</i> <i>Evidenca II.13. Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit.</i> <i>Evidenca II.20. Procedurë e transferimit të studentëve;</i> <i>Evidenca II.20.1. Procedurë e ekuivalentimit të studimeve;</i> https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret përcaktohen nga njësia bazë përgjegjëse për programin dhe i bëhet me dije QSHA nga UGJ. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, transferimet, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimit dhe diplomimit janë të kuptueshme dhe në dispozicion të publikut në faqen zyrtare online të UGJ-së.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konfirmoi që kriteret e pranimit të studentëve sipas viteve akademike gjenden në faqen online të Universitetit dhe mund të përdoret nga kushdo në çdo kohë.</p> <p>E gjithë struktura organizative e UGJ-së është në shërbim të studentëve në çdo fazë të studimeve dhe karrierës pa dallime. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin që zhvilloi me studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>RVB dhe takim i GVJ-së me studentët;</i> <i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër;</i> <i>Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër;</i> <i>Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, UGJ;</i> <i>Evidenca II.13. Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Krahas të dhënave që jepen në RVB-në e programit të studimit dhe dokumentacionit shoqëruar GVJ konfirmoi ekzistencën e kritereve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion ku studentët janë dakord për ekzistencën dhe aksesueshmërinë e të gjithë informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione këto që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Të interesuarit për të aplikuar në programin e studimit Bachelor në Turizëm mund të marrin informacion të detajuar edhe në faqen zyrtare online dhe rrjetet sociale të UGJ dhe Fakultetit Ekonomik.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>Pranimi i studentëve realizohet sipas sistemit meritë-preferencë. Në Rregulloret e Institucionit deri në nivel Njësie Bazë përshkruhen kriteret e pranimit, përzgjedhjes, ecurisë akademike, procesin e transferimit deri në procedurat e diplomimit të studentit.</p> <p>Studentët dhe të interesuarit kanë mundësi të marrin informacionin në forma të ndryshme: nëpërmjet faqes online të Universitetit, sekretarisë mësimore të FE-së, sekretarisë mësimore, si dhe shpalljeve në mjediset e Universitetit dhe Fakulteteve.</p> <p><i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, UGJ;</i> <i>Evidenca II.13. Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit;</i> https://uogj.edu.al; https://uogj.pitagora.rasb.al/login</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Pranimi për programet e studimit në UGJ të çdo kandidati që ka përfunduar ciklin e mesëm arsimor duhet të plotësojë këto kriteret: Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore (Llogaritur sipas VKM Nr.346, datë 19.04.2017). Në rastin e pikëve të barabarta merret në konsideratë mesatarja e provimeve shtetërore e në rast të njëjtë tjetër do të shihet mesatarja e tre viteve të shkollës së mesme.</p> <p>Për programin Bachelor në Turizëm, në NJBPET përveç mesatares së shkollës së mesme (50% e pikëve), ka një formulë të përlllogaritjes së 50% tjetër të pikëve. Sipas dokumenteve të dorëzuara formula e përlllogaritjes së peshës specifike sipas lëndëve (grup lëndëve) disiplinat bërthamë është: Ekonomi 20%; Matematikë 10%; Qytetari 15%; Gjuhë e huaj e parë 05%.</p> <p>Institucioni dëshmon se nuk aplikon kriteret shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Gjithashtu, Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar në bashkëpunim me Fakultetet e UGJ-së organizojnë edhe takime promovuese me nxënës e maturantë të shkollave mesme.</p> <p><i>Evidenca II.17.4. Vendimi i SA për kuotat e pranimit për vitin akademik 2022-2023 dhe kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca II.17.2. Kriteret e pranimit për vitin akademik 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.27. Pjesëmarrje në Panairin Work&Study 2022;</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Evidenca II.27.1. Pjesëmarrje në Panairin Work&Study 2023;</i> http://uogj.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konsaton se UGJ zbaton të gjitha aktet ligjore dhe VKM-të që lidhen me kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit dhe kushtet e përfitimit të ndihmë/bursave për shtresat në nevojë.</p> <p><i>Takimi GVJ me studentët;</i> <i>Evidenca II.17.4. Vendimi i SA për kuotat e pranimit për vitin akademik 2022-2023 dhe kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca II.17.2. Kriteret e pranimit për vitin akademik 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.18.1. Kuotat e pranimit 2023-2024;</i> <i>Evidenca II.19. Baza ligjore për aplikimet dhe regjistrimin në IAL.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar, verifikimi në faqen zyrtare online dhe nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se UGJ ka në vëmendje parashikimin e kuotave të pranimit për kategoritë e veçanta si dhe për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Kriteret dhe kuotat për këtë kategori studentësh hartohen dhe publikohen në Departamentet përkatëse, përcillen në dekanat dhe më pas SA merr vendimin përkatës. Në RVB përmendet që në përfundim të procedurave në IAL, kriteret dhe kuotat i përcillen MAS në afatet e përcaktuara.</p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>Evidenca II.17.4. Vendimi i SA për kuotat e pranimit për vitin akademik 2022-2023 dhe kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024;</i> <i>Evidenca II.17.2. Kriteret e pranimit për vitin akademik 2022-2023;</i> <i>Evidenca II.18.1. Kuotat e pranimit 2023-2024;</i> <i>Evidenca II.19. Baza ligjore për aplikimet dhe regjistrimin në IAL</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikimit të faqes online të Universitetit, GVJ konstaton se ai mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e tjera Institucionale për të hartuar politikat e ndihmës/bursave sipas kategorive përfituese. Kriteret dhe mënyrat e përfitimit të tyre publikohen në faqen zyrtare të UGJ-së, afishohen në mjediset e dedikuara në ndërtesat e IAL-së etj.</p> <p><i>Evidenca II.7 Vendimet e Bordit të Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta 2020-2023</i> https://uogj.edu.al/bursa-per-studentet/</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>IAL, GVJ konkludon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin për programin Bachelor në "Turizëm". Përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p><i>https://uogj.edu.al/</i> Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër;; Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër; Evidenca II.13. Rregullorja e NJBPET; Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, UGJ.</p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në UGJ studentët informohen në lidhje me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedurë është e rregulluar me dokumentacionin përkatës dhe parashikohet në nenet përkatëse për transferimet në Statutin e UGJ-së, Rregulloren e studimeve dhe rregulloreve në nivelet e tjera.</p> <p>Procedura, kuotat, kriteret etj. dhe informacione të detajuara merren pranë sekretarisë si dhe të shpallura në mjediset e UGJ-së.</p> <p>Institucioni ka kryer procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore nga programe të mëparshme studimi si dhe në kuadër të programeve të shkëmbimit Erasmus+.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;;</i> <i>Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, UGJ;</i> <i>Evidenca II.13. Rregullorja e NJBPET;</i> <i>Evidenca II.20. Procedurë e transferimit të studimeve;</i> <i>Evidenca II.20.1. Procedurë e ekuivalentimit të studimeve;</i> <i>Evidenca II.24. Procedurë Mobiliteti.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Gjirokastrës dhe NJBPET kujdesen për informimin e studentëve në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre gjatë programit të studimit. Ata marrin informacion në çdo kohë në lidhje me sistemin dhe format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, komisionet, shpalljen e rezultateve, formën e ankimimit etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimet me studentët dhe stafin akademik në IAL si dhe eksplorimi në faqen zyrtare online të UGJ-së, GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me procedurat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentë në ditët e vizistës në institucion.</p> <p><i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;;</i> <i>Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik, UGJ;</i> <i>Evidenca II.13. Rregullorja e NJBPET.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se Departamenti ndjek të gjitha mënyrat për të informuar saktë dhe në kohë studentët në lidhje me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit Bachelor në “Turizëm”. Studentët e gjejnë këtë informacion edhe në Rregulloren e studimeve në UGJ si dhe rregulloret e tjera deri në nivel programi.</p> <p><i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;;</i> <i>Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>“Bachelor” në Turizëm; Evidenca II.2. Plan mësimor 2021-2022; Evidenca II.15. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar; Evidenca II.15.1. Programi i fushave për mbrojtjen e temës së diplomës.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur në strategjinë e marketingut dhe të rekrutimit UGJ planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen. Në fillim të çdo viti akademik si dhe në mënyrë periodike UGJ organizon takime të hapur dhe publikon udhëzime për informimin e maturantëve. UGJ përdor edhe spotet televizive dhe fletëpalosjet promovuese për të informuar rreth programeve të studimit që ofron. Gjithashtu merr pjesë në panairin Work&Study. <i>Në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga RVB, nuk ka të dhëna nëse zhvillohet “Java e orientimit” me studentët në fillim të studimeve të tyre.</i></p> <p>Evidenca II. 27. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca II.27.1. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023.</p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se ai vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Turizëm” informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit. Përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>UGJ me Fakultetet e Departamentet përkatëse përdor format të ndryshme për të informuar studentët përsa i përket strukturës dhe kohëzgjatjes së programeve të studimit. Sipas RVB dhe takimit me studentët e stafin akademik, UGJ organizon ceremoninë e fillimit të vitit akademik. Gjithashtu, NJBPET organizon takim informues me studentet e vitit të parë, të cilët informohen rreth procesit mësimor, strukturës së vitit akademik, sezoneve të provimit, kohëzgjatjes së vitit akademik, planin mësimor dhe lëndët përkatëse, Rregulloret në fuqi etj. Ata informohen edhe për vendndodhjen e zyrave kryesore,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

	<p>laboratorëve, Bibliotekës etj. Studentët informohen edhe me anë të faqes zyrtare online të UGJ si dhe broshurave, afishimeve në këndin e njoftimeve etj.</p> <p><i>RVB dhe Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër;;</i> <i>Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër;</i> <i>Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit “Bachelor” në Turizëm;</i> https://uogj.edu.al/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p><i>Institucioni përdor disa mënyra për të informuar në çdo kohë studentët në lidhje me rregulloret e programit të studimit, planet mësimore, lëndët, mënyrat e vlerësimit etj. Përveçse të printuara, informacionet janë lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit të UGJ-së, gjithashtu shpërndahen nëpërmjet platformave të mësimi, si TEAMS, rrjeteve sociale etj.</i></p> <p><i>Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit “Bachelor” në Turizëm;</i> <i>Evidenca II.2. Plan mësimor 2021-2022;</i> https://uogj.edu.al/ <i>Viti i parë 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Për këtë arsye Institucioni merr pjesë në Panairin e Punës, ku studentët prezantohe me informacione dhe oferta për punësimin e ardhshëm.</p> <p>Lidhja e studentëve me tregun e punës dhe krijimin e kontakteve me punëdhënësit potencial sigurohet nga Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar. Në mbështetje të punësimit të ardhshëm të studentëve, UGJ ka nënshkruar dhe shumë marrëveshje me Institucione shtetërore dhe private.</p> <p><i>Evidenca IV.6. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA;</i> <i>Evidenca II. 27. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022;</i> <i>Evidenca II.27.1. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023;</i> <i>Evidenca II.21. Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni për Fakultetin Ekonomik;</i> <i>Evidenca Anekse – Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23);</i> <i>Evidenca I.18. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ-së.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinatorit të programit të studimit mban komunikim dhe informonte studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit.</p> <p><i>Vizita në Institucion;</i> <i>Takimi me studentët;</i> <i>RVB;</i> <i>https://uogj.edu.al/</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Për të siguruar shpërndarjen e informacioneve në çdo kohë dhe vend, UGJ përdor sistemin e menaxhimit të informacionit të brendshëm, Pitagora dhe ESSE 3. Sistemi përdoret nga stafi akademik, jo akademik dhe studentët për menaxhimin e informacioneve të ndryshme.</p> <p>GVJ, nuk mund të kontrollojë funksionimin e sistemit Pitagora, por në takimet me studentët dhe pedagogët ata konfirmuan përdorimin gjerësisht të tij për aspekte të ndryshme të menaxhimit të ciklit akademik.</p> <p><i>RVB;</i> <i>Takimi me stafin akademik dhe studentët;</i> <i>https://uogj.pitagora.rash.al/login</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton përmbushjen e të gjithë kriterëve lidhur me vënien në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit, nga ana e UGJ FE për programin Bachelor në "Turizëm". Kriteri përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa fizikisht dokumentacionin që lidhej me statistikat vjetore për numrin e studentëve që kanë aplikuar, vazhdojnë studimet dhe janë diplomuar në programin Bachelor në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>“Turizëm”. Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar në vitin akademik 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023 në Zyrën e Informacionit dhe Statistikës.</p> <p><i>GVJ konstatoi probleme me disa numra matrikullimi të studentëve në regjistrat fizikë dhe sugjeroi plotësimin e tyre.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca V.5. Rregullore e sekretarisë mësimore;</i> <i>Evidenca II.21. Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në vizitën në Institucion dhe zyrën e Sekretarisë Mësimore të Fakultetit Ekonomik, GVJ u njoh me regjistrat dhe statistikat në lidhje me studentët. Sekretaria mësimore ruan të dhënat në lidhje me regjistrimet e studentëve, tërheqjet, largimet para diplomimit etj. Të dhënat përcillen me shkresa të protokolluara në instancat e tjera. Nga kontrolli i rastësishëm i dosjeve të studentëve të dorëzuara në regjistrim në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi saktësi të dosjeve dhe dokumentacionit të tyre.</p> <p>Të dhënat për studentët përfshihen edhe në analizat vjetore të UGJ-së.</p> <p><i>RVB; Vizita e GVJ në Sekretarinë Mësimore të FE-së;</i> <i>Evidenca I.14. Raporti vjetor Ugj viti akademik 2019-2020;</i> <i>Evidenca I.14.2. Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021;</i> <i>Evidenca I.14.4. Raporti vjetor Ugj viti akademik 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në Institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ-së iu vunë në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin e studimit Bachelor në “Turizëm”. Gjithashtu përmes sistemit PITAGORA dhe ESSE 3 Institucioni e ka më të lehtë të gjenerojë statistika në çdo kohë.</p> <p><i>Vizita e GVJ në sekretarinë mësimore dhe RVB;</i> <i>https://uogj.pitagora.rash.al/login;</i> <i>Evidenca V.1. Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson</p>	<p>Në RVB deklarohet që UGJ mbështet me akte kontrolli periodik të dokumentacionit pranë Njësive Bazë, Njësive Kryesore dhe Sekretarive mësimore. Ajo vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. GVJ konstaton se nuk ka dokumente dhe evidenca që të vërtetojnë kryerjen periodike të auditimit të brendshëm. Në RVB dhe platformën e ASCAL janë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	vetëm Evidenca të auditimeve të kryera nga KLSH dhe MAS. RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca IV.17 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve; Evidenca IV.17.1 Raport i MASR AUDIT 2018; Evidenca IV.17.2 Raport i MASR AUDIT 2022.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	UGJ si Institucion harton raporte analitike të bazuar në Raportet vjetore të Njësive Bazë, të Fakulteteve, Sekretarive Mësimore, Drejtorisë së Shërbimeve Akademike e ndihmës akademike etj. Në dokumentet e dorëzuara në platformën e ASCAL-it, GVJ nuk gjeti evidenca në lidhje me raporte vjetore të hartuara nga NJBPET për analizën e cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve, cilësisë së punësimit të tyre etj. <i>Gjithashtu, disa Raporte vjetore në nivel IAL-je nuk janë të plota dhe kanë shumë pak të dhëna: si p.sh. Evidenca VI.3 Raport i vlerësimit të cilësisë dhe kurrikulave 21-22</i> RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca VI.3 Raport i vlerësimit të cilësisë dhe kurrikulave 21-22.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton përmbushje të shumicës së kërkesave dhe kritereve lidhur me vënien në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit, nga ana e UGJ, FE dhe NJBPET për programin e studimit Bachelor në "Turizëm". GVJ konstaton se nuk ka Raporte të auditimit të brendshëm periodik dhe raporte vjetore analizuese të hartuara nga Njësia Bazë, ku shqyrtohet arritja e objektivave për programet e studimit, si dhe puna me studentët dhe të dhënat për regjistrimin e tyre, numrin e të diplomuarve, të të punësuarve pas diplomimit etj. Kriteri përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve	Bazuar në Statutin e UGJ-së, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mësimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si: Senati Akademik; Këshilli i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Etikës; Këshilli i Studentëve etj. Evidencat shoqëruese dhe nga takimet në Institucion, GVJ konstaton se UGJ është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet e drejta e studentëve për tu përfaqësuar në strukturat e sipërpërmendura.</p> <p>RVB; Takimet e GVJ në Institucion; Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë; Evidenca II.29 Vendimi I SA per miratimin e anetareve te Senatit Akademik; Evidenca II.29.1 Lista e anetareve te Senatit Akademik; Evidenca II.30. Statuti i Këshillit Studentor; Evidenca II.30.2 Lista e keshillit studentor; Evidenca VI.4.1. Anëtarët e NjBSC ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-Të dhëna për anëtarët e NJBSC (tabela 24); Evidenca V.2. Statuti i shoqatës sportive UGJ.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e UGJ-së, Institucioni përdor disa forma të përfshirjen e studentëve në jetën akademike. Studentët dhe/ose përfaqësues të tyre përfshihen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik. Ata përfaqësohen në të gjitha nivelet e organeve Institucionale. Në Senat, studentët përfaqësohen me masën 10% (2 studentë). Përfaqësuesit e studentëve në Senatit Akademik të UGJ-së kanë të drejtë të shprehin mendime dhe të propozojnë në lidhje me problematikat me interes të përgjithshëm si dhe për plane mësimore dhe programet e studimeve, përmirësimin e rregullores së studimeve etj.</p> <p>Studentët marrin pjesë në procese të rëndësishme të jetës institucionale dhe akademike, si anëtarë të komiseve zgjedhore institucionale etj. Këshillat studentor veprojnë si organe të pavarur në këtë IAL.</p> <p>Në RVB nuk përmenden pyetësorë të zhvilluar me studentë në përfundim të semestrave ose vitit akademik. Gjithashtu, GVJ konstaton se në platformën e ASCAL ka të ngarkuar vetëm një pyetësor që vlerëson mësimin online i kryer në 2022, por nuk ka pyetësorë të mëvonshëm dhe që vlerësojnë mësimin në auditor.</p> <p>RVB; Takimet e GVJ në Institucion; Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë; Evidenca II.29.1 Lista e anetareve te Senatit Akademik; Evidenca V.3. Rregullore e zgjedhjeve 2020;</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Evidenca II.30. Statuti i Këshillit studentor.</p> <p>Bazuar në statutin e UGJ-së, studentëve u garantohej shprehja e mendimeve dhe propozimeve për përmirësim të planeve mësimore, programeve të studimit, rregulloreve dhe veprimtarive të tjera mësimore etj. Studentëve u garantohej cilësia e shërbimeve, zhvillimi i veprimtarive të tjera jashtë mësimin, si: kulturore, artistike, sportive etj.</p> <p>Në RVB përmendet se e drejta e studentëve për tu shprehur në lidhje me cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi, personelin akademik etj. garantohej me anë të sondazheve dhe pyetësorëve që u dërgohen studentëve, megjithatë GVJ vëren se mungojnë evidencat e mjaftueshme për të mbështetur këtë pohim. Nuk ka evidencat për pyetësorë ose sondazhe të dërguara studentëve për lëndë të veçanta, vlerësim të performancës së stafit akademik për programin Bachelor në “Turizëm” etj.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të shtohen sondazhet dhe pyetësorët për të garantuar këtë të drejtë të studentëve deri në nivel lënde ose moduli.</i></p> <p>RVB; Takim i GVJ me studentët; Evidenca III.6. Pyetësor studentor; Evidenca III.7. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u garantohej e drejta për të marrë informacion në lidhje me procedurën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në lëndë të ndryshme të programit Bachelor në “Turizëm”. Ata informohen për format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, të drejtën për të zhvilluar provimin, sezonin, data dhe komisionet e provimit, të drejtën për ankimim ose përmirësim të notës etj. Të gjitha Rregulloret funksionale në UGJ dhe Njësitë Kryesore e Bazë garantojnë këto të drejta të studentëve.</p> <p>RVB dhe Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca I.6. Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër;; Evidenca II.1. Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër; Evidenca II.6. Rregullore e Fakultetit Ekonomik; Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit “Bachelor” në Turizëm;</p>

	https://uogj.edu.al/		
Konkluzione	GVJ konstaton se standardi V.5 plotësohet kryesisht. Duke u mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar, RVB dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Institucioni plotëson përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe informohen për format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, për ankimimin etj, por nuk ka pyetësorë e sondazhe të kryera në vitet e fundit në rang Universiteti ose Njësie Kryesore e Bazë. GVJ sugjeron që të përgatiten dhe shpërndahen rregullisht pyetësorë e sondazhe për të vjelur mendimin e studentëve dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien në Programin Bachelor në Turizëm. Kriteri përmbushet kryesisht!		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në UGJ shpërndarja e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentëve të rinj, informimi për programet e ofruara, kurrikulat etj. ofrohen nga disa njësi si: Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative; Zyra Alumni e Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar; Sekretaritë mësimore; Departamenti etj. Përveç dhënies së informacionit, ato ofrojnë ndihmë për studentët edhe për diplomimin, këshillim për ndjekjen e studimeve në nivelin e dytë (Master), këshillim për punësimin dhe informim mbi sektorin shtetëror e privat dhe kërkesat e tyre për punonjësit e ardhshëm. Gjithashtu, organizohen edhe trajnime për studentët, info day, takime të hapura, pjesëmarrje në panairin Work and Study etj. Studentët marrin informacion dhe u jepet ndihmë edhe nga Sekretaria mësimore; Zyra e IT-së; Drejtoria e Shërbimeve Universitare etj. Sistemi i online PITAGORA dhe ESSE 3 dhe faqet online të UGJ-së gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm për informimin e studentëve në çdo kohë dhe vend. <i>Shënim: Edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe zyrën e informimit u vu re nga GVJ që informimi i studentëve kryhej në përputhje me aktet rregullatore të UGJ-së.</i> Në RVB përmendet Evidenca V.7 me titullin Rregullore për funksionimin e DSHNA-së, por në sistemin online të ASCAL ajo është në fakt Evidenca V.6.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca V.6 Rregullore për funksionimin e DSHNA-së;</i> <i>Evidenca V.5. Rregullore e Sekretarisë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UGJ ka marrë masat për ngritjen dhe funksionimit e sistemit të posaçëm për të realizuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve si dhe mbështetjen e tyre për çështje në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Disa nga njësitë që kujdesen për funksionimin e këtij sistemi në UGJ janë: Njësia Bazë; Sekretaria Mësimore e FE-së; Sektori i Standarteve dhe Kurrikulave etj. Përhapja e informacionit realizohet edhe duke përdorur llogaritë e Institucionit në rrjetet e ndryshme sociale si: facebook; instagram; faqja zyrtare e internetit etj. dhe platformat si PITAGORA dhe ESSE 3.</p> <p>RVB; <i>Takimet e GVJ-së me përfaqësues nga studentët dhe zyrat e ndryshme;</i> https://uogj.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>NJBPET në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore të Fakultetit Ekonomik, Zyrës Alumni etj., realizon informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve si dhe mbështetjen e tyre për çështje në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit Bachelor në Turizëm mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucione e biznese.</p> <p>Përveç saj, për komunikimin dhe informimin online të studentëve, UGJ ka në funksionimi disa platforma dhe aplikacione.</p> <p>RVB; <i>Takimet e GVJ-së me përfaqësues nga studentët dhe zyrat e ndryshme;</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca V.6 Rregullore për funksionimin e DSHNA-së;</i> https://uogj.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve</p>	<p>Raportet nga Zyra e Alumnit të Këshillimi të Karrierës dhe Vlerësimi të Vazhduar të përmendura në RVB dhe të dorëzuara në portalin e ASCAL, sipas GVJ-së kanë mangësira në analizë dhe në nxjerrje rezultatesh. Më shumë ato paraqiten si tabela me shifra për çdo program studimi. GVJ sugjeron që në vazhdim të merren masa për të pasur një gjurmim më të mirë dhe të detajuar të studentëve, të cilat të paraqiten në raporte më cilësore.</p> <p>RVB;</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



drejtuese përkatëse.	Evidenca II.21. Databazë Alumni; Evidenca II.21.1. Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni për FE.			
Konkluzione	GVJ konstaton se UGJ dhe NJBPET me anë të procedurave të tyre dhe njërive të posaçme kujdesen për studentët që nga pritja e tyre në vitin e parë, informimi, me informimin e studentëve, këshillimin, orientimin, menaxhimin e ankimimeve e problematikave etj., duke konkluduar se standarti V.6 plotësohet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Sipas RVB dhe nga vizita në Institucion e GVJ-së konstatohet se UGJ e ka në vëmendje cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të reja. Shumica e sallave janë pajisur me teknologjinë e duhur për të shtuar ndërveprimin në mësim dhe për përdorimin e ilustrimeve, videove, prezantimeve të ndryshme gjatë mësimin. Një vëmendje e veçantë për lehtësimin e punës së stafit dhe studentëve si dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie është bërë sidomos gjatë Pandemisë Covid-19, kur janë hartuar dhe shpërndarë disa manuale të përdorimit të platformave digjitale si: Office 365; Teams, Google Classroom; Edumeet etj.</p> <p><i>Pavarësisht përpjekjeve të UGJ për të përpiluar manuale për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimit të metodave inovative në lëndë/module të ndryshme, GVJ konstaton se shumica e manualeve janë me karakter teknik për përdorimin e platformave të ndryshme digjitale dhe nuk ka manuale për përmirësimin e mësimdhënies.</i></p> <p>RVB; Vizita e GVJ në Institucion dhe takimet me studentët dhe stafin;</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Evidenca III.1. Urdhër për platformën e mësimit online;</i> <i>Evidenca III.1.1. Implementimi i platformës së mësimit online Classroom;</i> <i>Evidenca III.1.3. Implementimi i platformës së mësimit online Office 365;</i> <i>Evidenca III.1.4. Manuali i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;</i> <i>Evidenca III.1.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët.</i> <i>Evidenca III.1.8. Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021;</i> <i>Evidenca VI.1. Manuali i Cilësisë në UGJ.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Spektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) i ngritur në UGJ është përgjegjëse për ngritjen, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në këtë Universitet. Funksionimi i këtij Spektori bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet e udhëzimet europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. Nga takimet e GVJ në Institucion me studentët, stafin dhe përfaqësues të Spektorit të Cilësisë, konfirmohet fakti se kjo njësi kryen procesin e monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtraive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore. Sipas RVB-së kjo Njësi kryen edhe pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara dhe organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. <i>Pavarësisht kësaj, GVJ konstaton se pyetësori i fundit i dërguar studentëve është ai për procesin e mësimit online gjatë Pandemisë Covid-19 dhe nuk ka të tjerë në vazhdim.</i></p> <p>UGJ ka ngritur edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, impementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ etj.</p> <p>RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër; Evidenca III. 6. Pyetësor studentor; Evidenca III. 7. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor; Evidenca II.22. Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave UGJ; Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC-së; Evidenca VI.4.1. Anëtarët e NJSBC-së në UGJ.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në statutin e UGJ-së garantohej përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Kjo gjë u garantohej nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese në nivel institucional dhe njësie kryesore, në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, të ushtrimit të të drejtës për ankimin e rezultatit të vlerësimit të dijeve etj.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të bëhet më shumë punë për përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të programeve të studimit, lëndëve dhe moduleve të ofruara, nëpërmjet organizimit të pyetësorëve dhe anketimeve të rregullta.</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca V.4. Vendimi për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit në NJBPET;</i> <i>Evidenca I.6. Rregullore e UGJ-së.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>UGJ nëpërmjet SSKC kujdeset që Fakultetet dhe njësitë bazë të raportojnë në mënyrë periodike mbi vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të tyre. Miratimi i paketës së instrumenteve matës së cilësisë e lehtëson dhe e standardizon këtë proces për çdo hallkë në Universitet.</p> <p>Vlerësimi i pedagogëve bëhet çdo fund viti duke u mbështetur në manualin e performancës, nga rishikimi i CV-ve të përditësuara dhe dosjeve përkatëse të dorëzuara në degën e Burimeve Njerëzore në UGJ. Nëpërmjet faqes zyrtare UGJ pasqyron në mënyrë transparente dhe bën publike politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Vizita e GVJ-së në Institucion;</i> <i>https://uogj.edu.al/transparenca/;</i> <i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca III.7. Raporti i analizës së pyetësorëve;</i> <i>Evidenca VI.9.1 Vendimi i miratimit të programit të transparencës 2023 i rishikuar;</i> <i>Evidenca VI.3. Raport vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022;</i> <i>Evidenca VI.3.2. Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të</p>	<p>UGJ ka marrë masat për të siguruar mekanizmat e duhura për vlerësimin e personelit akademik dhe të mësimdhënies. Shembujt e praktikave të mira promovohen në takime dhe organizime të ndryshme për të nxitur pjesën tjetër të stafit. Të dhënat në raportet e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>vlerësimin përdoren për nxitjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme.</p> <p><i>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe RVB, GVJ konstaton se këto mekanizma mbeten përgjithësisht në nivel Institucioni, shumë pak janë në nivel Njësie Kryesore dhe akoma më pak ose pothuajse nuk funksionojnë në Njësitë Bazë. Vlerësimi i pedagogëve dhe veprimtarisë së tyre shkencore duhet të jetë më i rregullt edhe në nivel Fakultetit ose Departamenti.</i></p> <p>Vizita e GVJ-së në Institucion; Evidenca I.14./I14.2/I.14.4 Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2019-2020/ 2020-2021/2021-2022; Evidenca I.14.14. Raport vjetor NJBPET 2021-2022.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe vizita e GVJ në Institucion dhe takimet me studentët e stafin, arrin në përfundimin se standardi 1 i fushës VI, përmbushet kryesisht, pasi disa elementë të tij mbeten të zbatuara vetëm në nivel Institucioni dhe nuk janë në nivel Njësie Kryesore ose Njësie Bazë. Gjithashtu, vëmendje e veçantë duhet për përgatitjen dhe shpërndarjen periodike të pyetësorëve dhe sondazheve për vlerësimin e kurrikulave, mësimdhënies etj. GVJ konkludon se kriteri përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UGJ ka hartuar politika dhe ka ngritur strukturat e duhura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave ndjek problemet që lidhen me mësimin dhe vlerësimin institucional. Gjithashtu, për menaxhimin e procesit të rishikimit të kurrikulave, programeve të studimit dhe reflektimit të tyre në Plafomat e Universitetit, është ngritur edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>RVB; Takimet e GVJ në Institucion; Evidenca I.2. Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025; Evidenca VI.3. Raport vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022;</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Evidenca VI.3.2. Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p> <p><i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Evidenca VI.4.1. Anëtarët e NJSBC;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UGJ kujdeset për mbarëvajtjen e programeve të studimit me instrumenta të ndryshëm matës. Dokumentet shoqëruese dhe vizita e GVJ-së në Institucion vërtetojnë se Institucioni harton raporte përmbledhëse dhe përpunon rezultatet e analizave dhe pyetësorëve nga të gjitha departamentet dhe fakultetet dhe çdo ndryshim e pasqyron dhe e bën të njohur për të gjithë studentët dhe stafin akademik.</p> <p>UGJ ka në funksion të mirë Sistemin e Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ka marrëveshje me shumë biznese dhe Institucione shtetërore me të cilët bashkëpunon për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshin edhe studentë e bashkëpunorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>NJSBC është strukturë pranë Rektoratit dhe përbëhet nga 7 anëtarë: katër anëtarë përfaqësues të personelit akademik të Njësisë Kryesore, dy anëtarë përfaqësues nga stafi administrativ (zyra e kurrikulave dhe kërkimi shkencor) dhe një përfaqësues nga trupa studentore.</p> <p><i>Evidenca I.2. Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025;</i></p> <p><i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC;</i></p> <p><i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i></p> <p><i>Evidenca I.18. Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i></p> <p><i>Evidenca II.27. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022;</i></p> <p><i>Evidenca II.27.1. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave ka rolin kryesor në përmbushjen e këtij kriteri për UGJ. Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe asaj kërkimore-shkencore kryhen nga ky sektor, nëpërmjet hartimit dhe shpërndarjes së pyetësorëve, anketave dhe instrumenteve të tjerë matës. Procesi nuk është kryer në mënyrë periodike në përputhje me rregulloren e këtij sektori.</p> <p>Në përmirësimin e cilësisë ndikon realizimi dhe përcjellja e analizës së rezultateve të pyetësorëve dhe raporteve nga fakultetet. Zyra kujdeset për nxjerrjen e detyrave dhe afateve kohore të përmbushjes së tyre në lidhje me pikat e dobta të evidentuara nga pyetësorët dhe anketat.</p> <p>Përsa i përket sigurimit të jashtëm të cilësisë, në UGJ si dhe në IAL-të e tjera në Shqipëri, realizohet nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike krahasuese si dhe proceseve që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>këtë kuadër, UGJ ka realizuar me sukses procesin e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë për akreditimin Institucional nga Bordi i Akreditimit të ASCAL. Gjithashtu, UGJ ka marrë pjesë edhe në vlerësimin nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2019 dhe 2020, rezultatet e të cilave janë bërë publike nga ASCAL.</p> <p>RVB; Takimet e GVJ në Institucion; https://uogj.edu.al/vendim-i-ba-dhe-crtifikata-e-akreditimit/ Evidenca I.9. Vendim i Akreditimit Institucional Periodik; Evidenca I.9.1. Miratimi i planit të veprimit për rekomandimet e akreditimit; Evidenca I.9.2. Plani i veprimit; Evidenca VI.2. Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Turizmit kryen procesin e rishikimit të kurrikulave dhe analizat mësimore dhe i dërgon propozimet në instancat më të larta në Senat dhe Rektorat, të cilat marrin vendime në lidhje me kërkesat për ndryshim dhe informacionin argumentues.</p> <p>Vendimet u komunikohen departamenteve dhe strukturave përkatëse për zbatimin e tyre. Përveç Departamentit edhe Sistemi i Sigurimit të Cilësisë dhe Kurrikulave realizon pyetësorë dhe harton raporte në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe nxitjes së praktikave të mira.</p> <p>Vizita e GVJ-së në Institucion; Evidenca I.1.Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër; Evidenca III.6. Pyetësor studentor; Evidenca II.22. Analizë mbi përshtatshmërinë e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër; Evidenca V.3. Raport i vlerësimit të cilësisë dhe kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.3.2. Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga takimet në Institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar GVJ arrin ne përfundimin se Institucioni përdor tregues të ndryshëm dhe të matshëm për përmirësimin e kurrikulës dhe për të promovuar arritjet më të mira të programit. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nëpërmjet NJSBC-së, Institucioni siguron mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. NJSBC-ja e Fakultetit Ekonomik është në funksionim dhe përbush detyrat e saj. Në vendimin që miraton krijimin e NJSBC-së përcaktohet edhe përbërja e saj me gjithsej 7 anëtar, nga të cilët 4 anëtar janë nga stafi akademik, 2 nga stafi jo akademik dhe 1 student. GVJ sugjeron që të ketë të paktën edhe një anëtar si ekspert të jashtëm, duke ulur të paktën me 1 anëtar përfaqësuesit e stafit akademik.</p> <p><i>RVB;</i> <i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>Evidenca I.14./I14.2/I.14.4 Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2019-2020/ 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca I.14.14. Raport vjetor NJBPET 2021-2022.</i> <i>Evidenca III.6. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>UGJ zbaton një politikë të caktuar për sigurimin e cilësisë deri në nivel departamenti, nëpërmjet kontrollit dhe vlerësimit të pedagogëve (të rinj dhe me përvojë), në bazë vjetore, analizës së rezultateve dhe hartimin e raporteve përkatëse.</p> <p>UGJ ka strukturat e posaçme të cilat hartojnë Raportet vjetore institucionale dhe raportet e vlerësimit të cilësisë. Këto raporte përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive dhe parashikimet për periudhat e ardhshme. Në bazë të procedurave për analizimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe lëndëve të programit të studimit, përpilohen më pas projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë në të gjitha strukturat.</p> <p><i>Evidenca VI.3. Raport i vlerësimit të cilësisë dhe kurrikulës 2021-2022;</i> <i>Evidenca VI.3.1. Raport i vlerësimit të cilësisë dhe kurrikulës 2020-2021;</i> <i>Evidenca VI.3.2. Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në</p>	<p>Fakultetit Ekonomik i UGJ-së dhe NJBPET realizon kontrollin dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>vlerësimin e programeve të studimit. Çdo vit përpilohen Raportet vjetore në të cilët vlerësohet mbarëvajtja e programeve të studimit. Procedura e kontrollit, vlerësimit dhe përmirësimit të kurrikulës dhe programeve të studimit që ofrohen nga NJBPET dhe FE përfshin rishikimin e tyre dhe të syllabuseve në fillim të vitit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit dhe anëtarët e stafit akademik, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e një viti më parë. Gjithashtu, gjatë vitit akademik Përgjegjësi i Departamentit kryen vëzhgime të herëpashershme në orët e zhvillimit të leksioneve, seminareve e laboratorëve për mbarëvajtjen dhe cilësinë e mësimdhënies. Rezultatet e vëzhgimeve, pyetësorëve etj. diskutohen në mbledhjet e departamentit ku inkurajohen dhe promovohen praktikatat pozitive dhe diskutohen ose merren masa për ndryshimin e rasteve me probleme dhe vështirësi në mësimdhënie. Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me titullarët e lëndëve në Njësitë Bazë, mbikqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera, ndjekin aktivitetin mësimor dhe shkencor të stafit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seancave laboratorike, detyrave të kursit, testimeve etj. Vlerësime dhe rekomandime për ndryshime në fuksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies vijnë edhe nga SSCK nëpërmjet Raportit vjetor të realizuar prej saj dhe publikimi i tij.</p> <p><i>Takimi i GVJ-së me studentët dhe stafin akademik të NJBPET; Evidenca I.14./I14.2/I.14.4 Raporti vjetor i UGJ-së, viti akademik 2019-2020/ 2020-2021/2021-2022; Evidenca I.14.10 Raport vjetor i FE 2021-2022; Evidenca I.14.13. Raport vjetor NJBPET 2020-2021; Evidenca I.14.14. Raport vjetor NJBPET 2021-2022;</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga vizita e takimet në Institucion, GVJ konstaton se UGJ dhe njësitë përbërëse të tij realizojnë vlerësimin e realizimit të programit me anë të metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit. Më së shumti përdoren raportimet direkte nga Departamentet dhe Fakultetit. GVJ sugjeron që të shtohen pyetësorët dhe sondazhet me studentët për vlerësimin e çdo pedagogu dhe çdo lënde në përfundim të saj, sipas semestrave. Gjithashtu si praktikë e mirë e Fakultetit Ekonomik në UGJ është edhe organizimi i workshopit me temë “Studentët dhe tregu i punës” me qëllim përmirësimin e kurrikulave dhe përshtatja e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së eksperiencave ndërmjet bashkëpunotërve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumnit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të dijuara nga ky program.	<i>Takimet e GVJ në Institucion dhe RVB;</i> <i>Evidenca III.6. Pyetësor studentor;</i> <i>Evidenca VI.2. Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve;</i> <i>Evidenca II.21. Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës;</i> <i>Evidenca II.27/II.27.1. Pjesëmarrje në Panair Work and Study 2022/2023.</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se Institucioni ka ngritur njësitë e posaçme për të realizuar monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe harton raporte për përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të studimit si dhe për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të të nxënit. GVJ shpreh vlerësimin: <i>Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UGJ në rregulloren e tij përcakton procedurat që garantojnë sigurimin e cilësisë. Strukturat përgjegjëse për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UGJ janë Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Gjithashtu, në rregulloret e Fakulteteve, Departamenteve dhe të programeve të studimit përcaktohen dhe hartohen politikat për realizimin e kësaj detyre. Procesi i sigurimit të cilësisë së programit të studimit garantohej edhe me anë të përfshirjes të studentëve në strukturat përkatëse. <i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë;</i> <i>Evidenca I.11. Organograma UGJ;</i> <i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC-së;</i> <i>Evidenca VI.4.1. Anëtarët e NJSBC.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe	Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe vizita e GVJ në Institucion, konstatohet që UGJ është i dedikuar për të përbushur si duhet këtë kriter nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një politike për sigurimin e cilësisë deri në nivel departamenti. Përveç pyetësorëve, përdoren edhe metoda të tjera për sigurimin e brendshëm të cilësisë. UGJ dhe departamentet përkatëse ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm të kurrikulave, syllabuseve, organizimi i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>leksioneve të hapura dhe nga lektorë të huaj të ftuar etj. SSSCK dhe NJSBC-ja krijojnë kushtet dhe mundësitë për të realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultetin Ekonomik të UGJ-së.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC dhe SSSCK në UGJ kryejnë të gjitha veprimtaritë e parashikuara në Statutin e Universitetit dhe rregulloret e miratuara, për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit. Vlerësimi i sigurisë së cilësisë realizohet edhe nga njësitë bazë e kryesore dhe ka gjithëpërfshirje me përfaqësues nga të gjithë aktorët: stafi akademik, ndihmës akademik, studentët, ekspert të jashtëm etj.</p> <p>NJBPET në përputhje me Statutin dhe në bashkëpunim me të gjitha nivelet e strukturave përbërëse të UGJ-së, është përgjegjëse për programet e studimit që ofron dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë së tyre.</p> <p>Njësia Bazë ngre njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në të cilën përfshihet si anëtar të paktën edhe 1 student. Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë dhe ofrimit të programit të studimit është proces i vazhdueshëm.</p> <p>NJSBC ofron ekspertizën dhe koordinon punën për realizimin e me sukses të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm të FE-së.</p> <p><i>Evidenca I.1. Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit “Bachelor” në Turizëm;</i> <i>Evidenca I.6. Rregullore e UGJ-së;</i> <i>Evidenca VI.4. Rregullore e NJSBC;</i> <i>Evidenca II.6. Rregullore e Njesisë Kryesore FE;</i> <i>Evidenca II.13. Rregullore e NJBPET;</i> <i>Evidenca V.4. Vendimi për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit Bachelor në Turizëm;</i> <i>Evidenca III.6. Pyetësor Studentor;</i> <i>Evidenca VI.2. Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>NJSBC-ja e UGJ-së ka në përbërje të saj përfaqësues nga Fakultetet (sipas propozimit të tyre), nga studentët, por nuk ka ekspert të jashtëm. Proceset e vlerësimit të brendshëm respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie ndaj personelit dhe studentëve duke respektuar lirinë dhe etikën akademike.</p> <p>Në Statutin e UGJ-së është parashikuar që vlerësimi i cilësisë së programit të studimit të realizohet nga studentët e kursit në mënyrë anonime dhe duke ruajtur konfidencialitetin e tyre, megjithatë GVJ konstaton se nuk ka dokumente që vërtetojnë realizimin periodik të këtyre pyetësorëve dhe sondazheve.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	Evidenca I.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë; Evidenca III.10. Kodi i Etikës.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Institucioni konsultohet dhe kërkon ndihmën edhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm në lidhje me kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo gjë do të ishte më efektive, nëse të paktën një nga anëtarët e NJSBC-së do të ishte një ekspert i jashtëm, përfaqësues i Institucioneve shtetërore ose bizneseve me të cilët UGJ ka marrëveshje.</p> <p>Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UGJ dhe NJBPET janë ftuar vazhdimisht ekspertë të huaj ose Profesorë të cilët kanë organizuar leksione të hapura. Aktivitete të tilla ndikojnë në rritjen e bashkëpunimit si dhe në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Turizëm.</p> <p>Gjithashtu, programi Bachelor në Turizëm promovohet edhe në panairë, workshope dhe aktivitete të tjera ku marrin pjesë subjektë shtetërore dhe private, të cilët u ofrojnë studentëve pozicionet e tyre vakante dhe japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij.</p> <p>Evidenca II.27. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca II.27.1. Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023.</p>			
Konkluzione	<p>Nga takimet në Institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar GVJ konkludon se institucioni ka një praktikë funksionale të përfshirjes së personelit akademik dhe jo akademik si dhe studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë që programit të studimit dhe raporton për rezultatet e marra. Gjithashtu, Institucioni fton sipas nevojës edhe ekspertë të jashtëm për të dhënë ekspertizën e tyre në lidhje me përmirësimin e programit dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së tij. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike	<p>Universiteti i Gjirokastrës dhe njësitë e tij hartojnë strategji dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Pyetësorët që zhvillohen me studentët dhe rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamenteve dhe janë publike për stafin.</p> <p>Nëpërmjet faqes zyrtare të internetit dhe programit të transparencës të shpallur në këtë faqe, bëhen publike të gjithë mekanizmat monitorues</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>si: Planet strategjike të punës, Planet e veprimtarive akademike kërkimore shkencore, Raportet e monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të vlerësimit të brendshëm etj.</p> <p><i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> https://uogj.edu.al/ https://uogj.edu.al/transparenca/ Evidenca VI.5. Vendim i Senatit akademik për miratimin e Programit të Transparencës 2023.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UGJ dhe njësitë përkatëse organizojnë rregullisht kontrollin e programeve të studimit, kryesisht me anë të pyetësorëve që u dërgohen studentëve dhe publikon rezultatet e tyre duke respektuar lirinë dhe etikën akademike. NJSBC dhe SSKC janë përgjegjëse për përpunimin e pyetësorëve dhe anketimeve si dhe për publikimin e rezultateve të tyre, duke iu përmbajtur parimit të sipërpërmendur.</p> <p><i>Evidenca III.1. Kodi i Etikës;</i> <i>Evidenca III.6. Pyetësor studentor;</i> <i>Evidenca III.7. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor;</i> Evidenca VI.2. Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të Studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në UGJ organizon mbledhje të Asamblesë ku diskutohet për programet e studimit, arritjet, problematikat, masat për përmirësim etj.</p> <p>Njësia Bazë pas analizimit dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit, përpilon Raportin që miratohet në Sentatin Akademik. Në Raport bashkëngjiten edhe propozimet e rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, të cilat më pas u përcillen strukturave përkatëse sipas parashikimeve. Në përfundim të këtyre fazave, përpilohet plani i veprimeve dhe masave që do të merren për përmirësimin e cilësisë, i cili gjithashtu miratohet në Senatit Akademik.</p> <p><i>GVJ sugjeron të shtohen pyetësorët dhe sondazhet periodike në nivel Institucion dhe Njësie Bazë, pasi nuk ka evidencë të pyetësorëve të kryer në përfundim të semestrave për lëndët ose modulet e ndjekura etj.</i></p> <p>RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca I.9. Vendim i Akreditimit Insitucional periodik; Evidenca I.9.2. Plani i veprimit për Akreditimin insitucional periodik; Evidenca III.7. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor;</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidenca I.14.4. Raport vjetor UGj, viti akademik 2021-2022;</i> <i>Evidenca I.14.14. Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore NJBPET 2021-2022.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar, RVB-ja dhe vizita e GVJ në Institucion, rezulton se NJSBC-ja e UGJ-së përgatit propozime për përmirësimin e cilësisë në vitin pasardhës, duke u mbështetur edhe në masat e marra një vit më parë.</p> <p>Në raportet e vlerësimit të brendshëm që hartohen prej kësaj njësie adresohen pikat e forta dhe të dobta dhe jepen propozimet për masat që duhet të merren për ndryshimet. Në përmirësimin e cilësisë së punës dhe ofrimit të shërbimeve të ndryshme për UGJ-në kanë shërbyer edhe adresimi dhe marrja e masave për plotësimin e rekomandimeve të lëna në kuadër të Akreditimit Institucional.</p> <p><i>RVB;</i> <i>Vizita e GVJ-së në Institucion;</i> <i>Evidenca III.7. Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor;</i> <i>Evidenca VI.3./VI.3.1. Raport vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca VI.3.2. Plani vjetor i Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Strukturat dhe programi i studimit vlerësohen periodikisht nëpërmjet SSK dhe NJSBC-së. Këto njësi dhe përfaqësuesit e saj japin informacione dhe organizojnë takime informuese në lidhje me aktivitetet e sigurimit të cilësisë në të gjitha njësitë e Universitetit si dhe organizojnë takime informuese në lidhje me ndryshimet dhe përmirësimet e zbatuara dhe të parashikuara.</p> <p><i>RVB;</i> <i>Vizita e GVJ në Institucion;</i> <i>https://uogj.edu.al/</i> <i>https://uogj.edu.al/transparenca/</i></p>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni organizon veprimtari periodike me stafin dhe studentet për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
---	----------------------	-----------------------------	----------------------------	-----------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




				X
--	--	--	--	---

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Turizëm” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “EOREM CABEJ” në Gjirokastrë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti i Gjirokastrës ka një pozitë strategjike në rajonin jugor dhe ka siguruar historikisht mbështetje dhe mundësi më të mëdha studimi për të gjithë studentët nga ky rajon dhe më gjerë.
2. Fakulteti i Ekonomisë në UGJ, i hapur fillimisht si filial i Unviersitetit të Tiranës në 1968, ka tashmë një përvojë të gjatë (mbi 50 vjeçare) dhe ka arritur të krijojë emrin e mirë në rajonin jugor e më gjerë si dhe është konsoliduar gjatë viteve.
3. Mbulimi i mësimdhënies mbi 70% me pedagogë të brendshëm gjë që rrit angazhimin e stafit të specializuar me përvoja aplikative në fusha të caktuara.
4. Ofrimi i programeve të përditësuara në fushën e Turizmit si një domosdoshmëri për të përgatitur brezin e ri për tregun e punës. FE në UGJ ka tre programe studimi për Turizmin në nivelin Bachelor (një prej tyre në bashkëpunim me Universitetin e Molises) dhe Master Profesional.
5. Programet përmirësohen vazhdimisht dhe metodat e përdorura në mësimdhënie duke aplikuar më shumë metodat së nxisin ndërveprimin, mendimin kritik, gjithpërfshirjen etj. Për përmirësimin e mësimdhënies merren parasysh edhe sugjerimet e dhëna nga studentët në pyetësorët vlerësues.
6. Organizimi i përvitshëm i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare dhe Konferencës studentore në nivel Fakulteti me pjesëmarrje të studiuesve të shquar të fushës ekonomike, kërkues shkencor nga Institucione të tjera homologe dhe të studentëve.
7. Përdorimi i platforamve/sistemeve të informatizuara për kontrollin e dijes dhe garantimin e transparencës siç është (Pitagora) për publikimin e vlerësimeve dhe për kontrollin e tyre të automatizuar (Cleanscore).
8. Universiteti i Gjirokastrës në përgjithësi dhe Fakulteti Ekonomik në veçanti kanë krijuar një rrjet partneriteti dhe kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me biznese dhe institucione të tjera shtetërore në mbështetje të objektivave të procesit mësimor, seminareve në terren dhe praktikave profesionale.
9. Qëndrueshmëri ndër vite në numrat e studentëve, që krahasuar me programe të tjera studimi në këtë Universitet e vendos atë në pozita kryesuese.
10. Përfshirje dhe vjelja e mendimit të studentëve në lidhje me metodat e përdorura në mësimdhënie dhe për vlerësimin e programit të studimit në funksion të përmirësimit të tij.



11. UGJ në mënyrë të vazhdueshme inkurajon dhe përfshin studentët në kërkimin shkencor me anë të pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre në konferenca, ëorkshope, projekte, botim në buletine shkencore etj.

Pika të dobta:

1. Mos kryerja e auditimit të brendshëm financiar dhe mungesa e planit financiar afatmesëm dhe aftagjatë.
2. Mos publikim në faqen online të UGJ të raportimeve financiare për çdo muaj.
3. Pasurimi i Bibliotekës nuk është kryer çdo vit dhe nuk është shtuar numri i personelit për të qenë në raport me numrin e studentëve dhe për tu shërbyer sa më mirë këtyre të fundit.
4. Pyetësorët që u dërgohen studentëve janë shumë të rrallë dhe i fundit është dërguar gjatë pandemisë së Covid-19 në vitin 2020.
5. Numër i ulët i pedagogëve me titullin "Profesor" në Departament gjë që ndikon në cilësinë e mësimdhënies.
6. Mungesa e një programi antiplagjiaturë të formalizuar dhe të siguruar nga UGJ.
7. Mospërputhje e kategorive të lëndëve mësimore me kufirin e parashikuar nga VKM nr. 41.

Rekomandime:

1. Të kryhen auditimet e brendshme financiare, të hartohen planet aftmesme dhe aftagjatë dhe të publikohen çdo vit në faqen zyrtare online të UGJ.
2. Departamenti duhet të bëjë përpjekje për angazhimin e një numri më të madh pedagogësh nga kategoria "Profesor" për të rritur më shumë cilësinë e mësimdhënies dhe aktivitetete të tjera në rang Departamenti dhe Universiteti.
3. Investim i UGJ-së në formalizimin e përdorimit të programit antiplagjiaturë duke bërë të mundur sigurimin e një programi të vetëm antiplagjiature në gjithë Institucionin.
4. Pasurimi i Bibliotekës çdo vit me tituj të rinj të botuar vitet e fundit dhe rishikimi i numrit të personelit, për t'iu përgjigjur numrit të studentëve dhe sigurimin e shërbimit cilësor dhe në kohë.
5. Të kryhen dhe të hartohen Raporte të auditimit të brendshëm periodik dhe raporte vjetore analizuese të hartuara nga Njësia Bazë, për të shqyrtuar arritjen e objektivave për programet e studimit, punën me studentët etj.
6. Të përgatiten dhe shpërndahen periodikisht pyetësorët dhe sondazhet te studentët për vlerësimin e kurrikulave, mësimdhënies etj.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Tourism" provided by the Higher Education Institution University "Eqrem Cabej" in Gjirokastra.

Strengths and affirmations

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



1. University of Gjirokastra has a strategic position in the southern region and historically has provided a great support and has offered study opportunities for all students from this region and beyond.
2. The Economic Faculty of UGJ, established initially as a subsidiary of University of Tirana in 1968, has already a long experience (over 50 years) and has managed to create a good reputation in the southern region and beyond, as well as has been affirmed in these long years.
3. Over 70% of teaching process is from the effective Academic staff, which increases the commitment of specialized staff who have long experience in the Economic and Touristic field of study.
4. Commitment to update the study programs in the field of Tourism as a necessity to prepare the new generation for the labor market. FE at UGJ has three study programs for Tourism at the Bachelor level (one of them in collaboration with the University of Molise) and Professional Master.
5. The study programs and teaching methods are constantly improved in order to encourage more interaction, critical thinking, inclusiveness, etc. For the improvement of teaching, the staff is considering also the suggestions given by the students in the evaluation questionnaires.
6. Organization of the annual International Scientific Conference and the Student Conference at the Faculty level with the participation of prominent researchers in the economic field, scientific researchers from other homologous Institutions and students.
7. Use of digital platforms/systems such as (Pitagora) for the publication of evaluations and for their automated control (Cleanscore) to guarantee transparency in student's courses' evaluation.
8. University of Gjirokastra in general and particularly the Faculty of Economics have build a network of partnership and have signed cooperation agreements with counterpart Institutions inside and outside the country, with businesses and other state institutions in support of the objectives of the learning process, field works and internships.
9. Stability over the years in the number of students, which compared to other study programs in this University places it in a leading position.
10. Involvement and gathering of students' opinion regarding the methods used in teaching and for evaluating the study program in order to improve it.
11. UGJ constantly encourages and involves students in scientific research through their participation and engagement in conferences, workshops, projects, publication in scientific bulletins, etc.

Weaknesses

1. The Faculty or University is not performing the internal financial audit and it has not drafted a mid-term and long-term financial plan.
2. The financial reports are not being published monthly in the UGJ website.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



2. The enrichment of the Library has not been carried out every year and the number of staff has not been increased to be in relation to the number of students and to guarantee a proper service to them.
3. Questionnaires sent to students are very rare and the last one was sent during the Covid-19 pandemic in 2020.
4. Low number of lecturers with the academic title "Professor" in the Department, which affects the quality of teaching.
5. Lack of a formalized anti-plagiarism program provided by UGJ.
6. Discordance of the categorization of the program courses with the limit established by VKM (Decision of the Council of Ministers) no. 41.

Recommendation

1. The Institution should perform Internal financial audits and to draft and approve mid-term and long-term plans, which then should be published every year on the official website of UGJ.
2. The Department should make an effort to engage a greater number of lecturers from the "Professor" category to further increase the quality of teaching and other activities at the Department and University level.
3. UGJ should invest in formalizing the use of the anti-plagiarism program, making it possible to provide a single anti-plagiarism program throughout the Institution.
4. The Library should be enriched every year with publications of recent years and the number of staff working in the Library should be reviewed to respond to the number of students to ensure quality in the service offered.
5. To carry out and draft periodic internal audit reports and annual analytical reports drafted from the Departments, to evaluate the achievement of objectives for the study programs, work with students, etc.
6. Periodically prepare and distribute questionnaires and surveys to students for the evaluation of curricula, teaching, etc.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

